



Il Ticino in breve

Informazioni generali

Kujdes

Ky publikim ka për qëllim t'u ofrojë informacion të përgjithshëm mbi Kantonin të gjithë personave që mendojnë të vendosen në Ticino. Përmbajtja e këtij dokumenti nuk synon të jetë gjithëpërfshirëse: përkundrazi, Kancelaritë e Komunave të Kantonit Ticino, ashtu si edhe entet e shumta, shoqatat dhe zyrat e Administratës kantonale të treguara në dokument, mund të ofrojnë informacione shtesë, qartësime më në thellësi dhe, nëse kërkohet dhe është e nevojshme, konsulenca kompetente të personalizuar.

Të gjitha informacionet janë kontrolluar me kujdesin maksimal dhe konsiderohen të sakta në kohën e publikimit të tyre. Megjithatë, nuk përjashtohet që duke konsideruar numrin e madh të të dhënave, mund të ketë gabime për të cilat ju kërkohet ndjesë paraprakisht. Autorët e këtij publikimi heqin dorë nga çdo përgjegjësi në lidhje me saktësinë, korrektësinë, besueshmërinë dhe tërësinë e përmbajtjes së sajteve të internetit të shënuara. Të gjitha të dhënat e treguara i referohen vitit 2012.

Indeksi

Hyrje	4
1. Ticino shkurtimisht	5
2. Vendosja në Ticino Lejet e qëndrimit	6 7
3. Demokracia dhe federalizmi	8/9
4. Jetesa në Ticino	10
5. Gjuha italiane dhe bashkëjetesa	12
6. Shkolla dhe formimi	13
7. Integrimi i të huajve dhe parandalimi i diskriminimit	14/15
8. Të punosh në Ticino	16
9. Ekonomia, tatimet dhe mjetet e komunikimit	17
10. Lëvizja	18/19
11. Shëndetësia	20
12. Siguria shoqërore	22/23
13. Familja Fëmijëria dhe rinia	24 25
14. Feja	26
15. Koha e lirë dhe media	27
16. Siguria dhe emergjencat	28
Bibliografia	29
30 fjalë për të kuptuar italishten e folur në Ticino	30
Numra të dobishëm	30

Kur jashtë vendit mendojnë për Zvicrën, shpesh imagjinohet një vend baritor; me liqene me ujë të kristaltë, pyje me pisha, male të mbuluara me dëborë të përjetshme, lugina që përshkohen nga trena të kuq, kodra të gjelbra të mbushura aty-këtu me yllin e alpeve dhe kabina druri, lopë e dhi që kullotin, me (qen) San Bernardë kudo, burra që

Zvicra ka 346 km kufi me Gjermaninë, 572 km me Francën, 734 km me Italinë, 165 km me Austrinë dhe 41 km me Lihtenshtejnin. Sipërfaqja e saj është 41 285 km², nga të cilat 74,5% janë sipërfaqe prodhuese (30,8% pyje, 36,9% sipërfaqe e shfrytëzueshme bujqësore, 6,8% zona të banuara) dhe 25,5% janë ujëra dhe tokë e pashfrytëzueshme. Zonat më të mëdha urbane janë Cyrihu (me rreth 1,2 milionë banorë), Gjeneva (rreth 530 000 banorë), Bazeli (rreth 500 000 banorë), Berna (rreth 355 000 banorë), Lozana (rreth 335 000 banorë), Luçerna (rreth 210 000 banorë), San Gallo (rreth 150 000 banorë), Vinterturi (rreth 140 000 banorë), Lugano (rreth 138 000 banorë). Popullsia përbëhet nga rreth 8 milionë banorë, nga të cilët 22,8% janë të huaj (rreth 1 815 000 banorë). Gjuhët kombëtare janë gjermanishtja, 63,7%, frëngjishtja 20,4%, italishtja 6,5%, gjuha romanshë 0,5%. Grupet kryesore fetare përbëhen nga katolikët 41,8%, protestantët 35,3%, myslimanët 4,3%. (Të dhënat e vitit 2012)

Nga viti 1848 Konfederata e Zvicrës është një shtet federal i përbërë sot nga 26 kantone (20 kantone dhe 6 gjysmë-kantone). Qeveria është një organ kolegjal (Këshill Federal) me 7 anëtarë. Parlamenti (Asambleja Federale) përbëhet nga 2 dhoma: Këshilli i Shtetit (që përfaqëson kantonet) me 46 anëtarë dhe Këshilli Kombëtar (që përfaqëson popullin) me 200 anëtarë.

i bien birit të alpeve dhe punojnë në ndonjë fabrikë orësh apo në bankë, dhe me Hajdit bionde që përgatisin «fondue», «raclette», «rösti» apo «birchermüsli» për turistët amatorë të skive. Të tjerë e mendojnë Zvicrën ndryshe, si vendin e të gjithë të mirave, e parave, sekreteve bankare, rrugëve të shtruara me flori, çokollatës që derdhet lumë, djathit me vrime, bunkerëve ushtarakë e vendstrehimeve anti-atomike, e thikave zvicerane, e harqeve, e neutralitetit, e kufijve të mbyllur, e rregullit dhe pastërtisë. Të tjerë madje njohin te kryqi zviceran, i bardhë me sfond të kuq, simbolin e Kryqit të Kuq (me sfond të bardhë), përkushtimin humanitar, federalizmin, si edhe vlerat që kanë krijuar mitet e Vilhelm Telit, Vinkelriedit, të Helvetias, të gjeneral Guisanit, të mercenarëve, të rojeve të papës, të Ruisë, të Ursula Anores, të Rozher Federer, të Linjit, të Le Corbusier, të celularëve UEM, të trenave gjithmonë të përpiktë, të autobusëve të verdhë, të Crossair e të Swissair. Ka edhe të tillë që e identifikon Zvicrën me vende të tilla si Cervino, Jungfrau, Kapellbrücke e Luçernas, shpellën e arinjve të Bernës, «Jet d'eau» të Gjenevës, Kështjellës Chillon, ujëvarat e Renos, San Gottardo, Forumi i Davosit, pallatet luksoze të Zernatit, Gstaad apo Sankt Moritz. Madje ka edhe nga ata që na ngatërrojnë me Suedinë apo Svazilandin, dhe nga ata që na imagjinojnë si tirolezët, të pasur dhe barkmëdhenj.

Janë të shumtë stereotipat dhe vendet e përbashkëta, shpesh frutë i një «Swiss made» të veçantë, të cilat në tërësi kontribuojnë në formimin e identitetit zviceran, ose të paktë të një pjese të realitetit të tij kompleks, ndoshta ajo që vërehet më shumë jashtë vendit. Stereotipa që megjithatë nuk duket se i referohen menjëherë edhe Ticino. Domethënë të jetosh në Ticino nuk është si të jetosh në Zvicër? A është Ticino Zvicër? Sigurisht, sepse gjuha e saj italishtja, kultura e saj lombarde, klima e saj mesdhetare, janë pjesë përbërëse dhe e pandashme e identitetit zviceran. Shumë shpesh jashtë vendit, por edhe në zonat e tjera të vendit, e kanë të vështirë ta mendojnë Helvetian si një rajon nën-tropikal, me palma, aloe, fiq Indie, vreshta, ullinj, limonë e temperatura verore mbi 30°C! Ticino merr pjesë në mozaikun «Zvicër» jo vetëm me Gazosa Mendrisio dhe djathin «Zincarlin della Val di Muggio», por edhe me kështjellat mesjetare të Bellinzona e Spliit të Valle Bavona, me operat e Françesko Borromini dhe pallatet e Mario Botta në Lugano, me Festivalin Ndërkombëtar të Filmit të Locarno dhe Teatrin Dimitri, me fosilet e dinozaurëve të malit San Giorgio e me kishat e stilit roman të luginave, me vajin e ullirit të Ceresio e me Qendrën Zvicerane të Kalkulimeve Shkencore. Këto dhe aspekte të tjera të Ticino, unike në nivel kombëtar, kontribuojnë në mënyrë aktive në suksesin e asaj «Swiss made» të kërkuar, famshëm, e ndonjëherë që e kanë zili.

«Në Itali, nën sundimin e familjes Borgia, për tridhjetë vjet patën luftëra, terror, vrasje e masakra: dhe nxorën Mikelandhelon, Leonardo da Vincin dhe Rilindjen. Në Zvicër, kishin dashuri vëllazërore, pesëqind vjet paqe e demokraci, e çfarë nxorën? Orët me lavjerrës.»
(Batutë e Orson Welles në filmin «The third man» (1949) të Carol Reed)

Repubblica e Cantone Ticino
Dipartimento delle istituzioni
Delegato cantonale all'integrazione degli stranieri

Ticino shkurtimisht

Klima e butë, vegjetacioni nën-tropikal, konfigurimi i territorit, qendrat urbane, gastronomia, kultura, historia dhe gjuha italiane e dallojnë kantonin Ticino nga pjesa tjetër e Zvicrës. Kanton unik i vendosur plotësisht në jug të Alpeve, përgjatë 100 km të tij gjejmë të përqendruara të gjitha llojet e vegjetacionit evropian, nga likenet në Alpe e deri te vreshtat dhe palmat në brigjet e liqeneve. Përbëhet nga dy zona gjeografike kryesore të ndara nga mali Ceneri: Zona Sopraceneri ka një strukturë alpine dhe përshkohet nga rrjedha e sipërme e lumit Ticino; Zona Sottoceneri përkundrazi paraqet karakteristika prealpine dhe përshin territorin e «Campione d'Italia». Tokë e kulturës italiane, por politikisht zvicerane, kantoni është një rajon modern e dinamik që përshkohet nga akse të rëndësishme të transitit hekurudhor dhe autostradave evropiane, dhe është lehtësisht i arritshëm edhe me aeroplan.


Ticino ndodhet në qendër të të ashtuquajturit Rajoni Insubrica, kufizohet me Italinë dhe me kantonet Valis, Uri e Grison. Emërtimi zyrtar është Republika dhe Kantoni Ticino, gjuha zyrtare është italishtja dhe kryeqyteti është Bellinzona: së bashku me katër lugina italishtfolëse griseze përbën Zvicrën italiane, ka një sipërfaqe prej 2812 km², e barabartë me 6,8% të sipërfaqe totale zvicerane, e pothuajse 340 000 banorë (2012) kryesisht katolikë, të përqendruar

Kantoni Ticino (Tessin ose Tisin në dialektin e Kanton Ticino) e merr emrin nga lumi Ticino që e përshkon nga burimi, në Passo della Novena e deri në liqenin Maggiore. Sipas Kushtetutës kantonale «Kantoni Ticino është një Republikë demokratike me kulturë dhe gjuhë italiane» (neni 1 i Kushtetutës) dhe parathënia qartëson se «populli tiçinez» është «besnik ndaj detyrës historike për të interpretuar kulturën italiane në Konfederatën Helvetike».

veçanërisht në qendrat urbane të Lugano (135 000 banorë), qendra e tretë financiar zvicerane, Locarno/Ascona (55 000 banorë), Bellinzona (50 000 banorë) dhe Chiasso/Mendrisio (50 000 banorë). Mbi 26% e popullsisë rezidente në Ticino është e huaj.

Gjurmë të historisë

Në lashtësi tokat tiçineze banoreshin nga lepontët, një popullatë kelte. Më pas u aneksuan nga perandoria romake dhe u bënë pjesë e Retias. Gjatë mesjetës, vijuan ngjarjet e Lombardisë fqinje, me pushtimet e ostrogotëve, longobardëve dhe frankëve. Më pas u bënë skenë lufte mes komunave të Komos dhe Milanos dhe u pushtuan përfundimisht në gjysmën e shekullit të XIV nga dukët e Milanos, Viskontët dhe më pas nga familja Sforca. Në vitin 1182 luginat Blenio dhe Leventina nënshkruan Paktin e Torres duke u betuar për ndihmë reciproke si pararendëse e Paktit të Grütli në vitin 1291, akti legjendar themelues i Zvicrës. Më pas rajoni dalëngadalë u pushtua nga kantonet zvicerane që synonin kontrollin e kalimeve alpine, në veçanti të San Gottardo. Në vitin 1512 territori i kantonit të tanishëm Ticino u nda në tetë komuna kalorësiake të administruara nga kantonet e konfederuara, që në vitin 1798 u aneksuan nga Republika Helvetike, që u shpërbë më pas në vitin 1803 nga Napolon Bonaparti i cili e transformoi në një konfederatë me 19 kantone. Në vitin 1798 elementët të Republikës Cizalpine zbarkuan papritur në Lugano, por ndeshën në rezistencën e Vullnetarëve të fshatit, një trupë rojesh e krijuar nga popullsia vendase. Vijoi një ditë me luftime të ashpra në përfundim të të cilës Cizalpinët, megjithë suksesin që patën në fillim, u sprapsën. Elementët më të hapur të borgjezisë luganeze përfituan nga ngjarjet për të realizuar pavarësinë e aspiruar të rajonit me moton «të lirë dhe zviceranë». Me Aktin mbi Ndërmjetësimin e datës 19 shkurt 1803 perandori i ngriti në rangun



e kantoneve të pavarura edhe territoret që kishin qenë të nënshtruara, siç ishte Ticino. Nga viti 1878 Bellinzona është kryeqyteti i vetëm dhe i përhershëm. Gjatë shekullit XIX, kantoni vuajti një regres ekonomik si pasojë e të cilit pati një emigrim të madh drejt vendeve evropiane dhe përtej oqeanit. Gjendja filloi të ndryshojë vetëm me fillimin e turizmit, hapjes së hekurudhës San Gottardo dhe me fillimin e industrializimit në fillim të viteve 1900. Në gjysmën e dytë të shekullit XX kantoni u njoh si qendër e rëndësishme financiare dhe e shërbimeve. Themelimi në vitin 1996 të Universitetit të Zvicrës Italiane përfaqësoi kurorëzimin e kësaj rritjeje ekonomike dhe kulturore. Ekonomia e Kantonit Ticino sot përbëhet mbi të gjitha nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Pjesa më e madhe e popullsisë aktive është e punësuar në sektorin e shërbimeve (banka, sigurime, tregti, turizëm, administratë), një e treta në industri, dhe vetëm 2% në bujqësi.

Vendosja në Ticino

2

Që prej 12 dhjetorit 2008 Zvicra bën pjesë në hapësirën Schengen. Për qëndrimet deri në tre muaj për turizëm për shtetasit e huaj që u nevojitet vizë (pra jo shtetasit e BE-së dhe Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë) jepet, sipas kushteve të caktuara, një vizë Schengen e vlefshme për të gjithë zonën Schengen. Për të hyrë në Zvicër, shtetasve të huaj u nevojitet edhe një dokument identifikimi i vlefshëm dhe i njohur. Përveç kësaj nevojitet që të disponojnë mjetet e nevojshme financiare mbështetëse gjatë transitit ose qëndrimit, ose që këto mjete të sigurohen në mënyrë ligjore. Zyra Federale e Emigracionit (UFM), Përfaqësitë zvicerane jashtë vendit dhe Autoritetet Kantonale kompetente

Në 21 qershor 1999, Bashkimi Evropian (BE) dhe Zvicra firmosën një numër marrëveshjes dypalëshe, mes të cilave edhe marrëveshjen mbi lëvizjen e lirë të njerëzve, e cila hyri në fuqi në 1 qershor 2002. Pas zgjerimit të BE-së në vitin 2004, marrëveshja u plotësua nga një protokoll që hyri në fuqi në vitin 2006 i cili disiplinon hyrjen progresive të lëvizjes së lirë të njerëzve edhe për shtetasit e Estonisë, Letonisë, Lituanisë, Polonisë, Republikës Çeke, Sllovakisë, Sllovenisë, Hungarisë, Qipros dhe Maltës. Në vitin 2009 zgjedhësit zviceranë miratuan rinovimin e marrëveshjes mbi lëvizjen e lirë të njerëzve dhe shtrirjen e saj edhe për shtetasit e Bulgarisë dhe Rumanisë.

për çështjet e të huajve mund të ofrojnë informacion të nevojshëm mbi kushtet e përgjithshme të hyrjes. Shtetasit e huaj që kanë hyrë ligjërisht në Zvicër për turizëm, nuk kanë nevojë për një leje banimi nëse qëndrimi i tyre nuk kalon tre muaj brenda një periudhe prej gjashtë muajsh në hapësirën Schengen. Shtetasit e huaj, të cilëve u nevojitet vizë, janë të detyruar të respektojnë kohëzgjatjen dhe qëllimin e qëndrimit të tyre të shënuar në vizë. Të huajt, që për arsye serioze nuk arrijnë të largohen nga Zvicra brenda periudhës së parashikuar, janë të detyruar të paraqiten menjëherë pranë autoritetit kompetent komunal dhe kantonial. Kushdo që strehon persona të huaj kundrejt pagesës është i detyruar të njoftojë menjëherë autoritetet kompetente.

Shtetasit e huaj që nuk vijnë nga një vend i BE-së/SHETL-së, duhet të sigurojnë autorizimin/sigurimin përkatës të hyrjes për t'u vendosur në Zvicër. Brenda 14 ditëve nga hyrja, por përpara se të fillojë aktivitetin e punës, janë të detyruar të paraqiten pranë shërbimit rajonal për të huajt, kompetent për vendin e tyre të qëndrimit, dhe gjithashtu duhet të paraqiten pranë autoritetit komunal. Çdo ndryshim adrese, edhe nëse është brenda vetë komunës, ashtu edhe largimi jashtë vendit, duhet të njoftohet pranë autoriteteve të lartpërmendura. Shtyrja/rinovimi i lejes për të huajt duhet të kërkohet të paktën dy javë përpara skadimit të saj.

→ Shih «Informacion i dobishëm»

Vlerat themelore, të drejtat dhe përgjegjësitë

Kushtetuta federale zvicerane përcakton të drejtat themelore dhe rregullat për bashkëjetesën dhe raportin me shtetin. Ajo shpërndan gjithashtu kompetencat dhe përgjegjësitë mes Konfederatës dhe kantoneve. Kushtetuta federale aplikohet në të gjithë Zvicrën dhe çdo kanton ka një të vetën. Kantoni Ticino i jep rëndësi të madhe faktit që të respektohen në mënyrë reciproke liria e çdo qenieje njerëzore dhe rregullat e bashkëjetesës. Kjo presupozon që të gjithë t'i njohin këto vlera themelore mes të cilave përmendim: respektin dhe kujdesin për dinjitetin njerëzor; të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta, liria e individit kufizohet nga liria e të tjerëve, ligjet dhe rregulloret e shtetit duhen respektuar. Kush jeton në Zvicër ka gjithashtu përgjegjësinë të kontribuojë në shpenzimet e shërbimeve publike, të paguajë taksat, të lidhë sigurim shëndetësor; të derdhë kontributet për sigurime shoqërore. Për fëmijët është në fuqi detyrimi i shkollimit.

Prej emigrantëve, ashtu si prej shtetasve të saj, Zvicra pret që të interesohen edhe për marrëdhëniet dhe kushtet e tjera shoqërore si edhe që të dinë si të komunikojnë me fqinjët, të regjistrohen pranë një shoqate, të marrin pjesë në manifestime dhe tradita vendase, të jenë vullnetarë në fushën kulturore, sportive ose sociale. Dhe mbi të gjitha të kërkojnë të njohin, të respektojnë e të asimilojnë parimet dhe vlerat themelore të vendit mikpritës. Të gjithë të huajt duhet të mësojnë një nga gjuhët kombëtare. Në kantonin Ticino të gjithë të porsaardhurit duhet të mësojnë të flasin, lexojnë dhe shkruajnë italisht. Nga ana e tyre, zviceranët duhet të tregojnë vullnetin e duhur për të qenë të hapur për të pranuar të porsaardhurit.

→ Shih kapitullin 7 – Integrimi i të huajve

f.14/15

Lejet e qëndrimit

Autoritetet kompetente për qëndrimin dhe banimin

Për vendimet në lidhje me qëndrimin dhe banimin për shtetasit e huaj janë kompetente kantonet përkatëse të qëndrimit. Në përputhje me parimet, kantonet vendosin lirisht në bazë të ligjeve në fuqi, nëse duhet të lëshojnë apo jo një leje qëndrimi për të huajt. Autoritetet kantonale të emigrimit janë përgjegjëse për kontrollimin e banorëve të huaj. Vendimi në lidhje me procedurat në fushën e azilit, u përket autoriteteve federale dhe ligjit përkatës federal mbi azilin (LASi).
→ Shih «Informacion i dobishëm»

Regjimi i aplikuar për shtetasit e BE-së/SHETL-së

Marrëveshja mbi lëvizjen e lirë të njerëzve dhe protokollet përkatëse aplikohen për shtetasit e vendeve të BE-së/SHETL-së, për të cilët, ndryshe nga shtetasit e vendeve të treta, janë lehtësuar kushtet për marrjen e një lejeje qëndrimi dhe/ose pune në Zvicër. Me të drejtën e lëvizjes së lirë të njerëzve lidhen dispozitat e njohjes së ekuivalencës së diplomave profesionale, e të drejtës për blerjen e pronave të paluajtshme dhe të koordinimit të sistemit të sigurimeve shoqërore.



Regjimi i aplikuar për shtetasit e vendeve të treta

Për shtetasit e vendeve të treta (që nuk u përkasin BE-së/SHETL-së) aplikohet ligji federal mbi të huajt (LStr) dhe dekreti mbi pranimin, lejen e qëndrimit dhe aktivitetin fitimprurës (OASA). Pranimi dhe dhënia e lejeve të qëndrimit për të huajt e këtyre vendeve është më i kufizuar se për shtetasit e BE-së/SHETL-së. Leja për të huajt për të ushtruar një aktivitet fitimprurës mund të jepet nëse respektohen dispozitat në lidhje me tregun e punës dhe legjislacionin e lartpërmendur; megjithatë nuk ekziston e drejta për marrjen e kësaj lejeje.

Bashkimi familjar për shtetasit e vendeve të treta

Shtetasit e vendeve të treta që mbajnë leje banimi «C», qëndrimi «B» dhe qëndrimi të përkohshëm «L», bashkë me shtetasit zviceranë, kanë mundësinë të kërkojnë bashkim familjar për bashkëshortin/bashkëshorten dhe fëmijët nën 18 vjeç të pamartuar. Autoritetet kompetente mbi emigracionin mund të autorizojnë bashkimin familjar nëse plotësohen kushte të caktuara (për shembull: të disponohet një vendbanim i përshtatshëm, të ardhura të mjaftueshme, etj.).

Nënshtetësia zvicerane

Nënshtetësia zvicerane mund të përfitohet nga origjina, përmes adoptimit nga ana e një shtetasi/shtetaseje zvicerane, ose duke përmbushur një procedurë specifike. Nënshtetësia zvicerane përmban një sërë të drejtash dhe përgjegjësisht (p.sh. e drejta për të votuar dhe e drejta për t'u zgjedhur; detyrimi i kryerjes së shërbimit ushtarak). Nënshtetësia mund të merret përmes një procedure natyralizimi të zakonshëm ose të lehtësuar. Ndryshimi i vendbanimit nga një kanton në një tjetër; mund të ndikojë në kërkesën e natyralizimit. Informacione të mëtejshme mund të merren pranë autoriteteve komunale, seksioni i popullsisë ose pranë zyrave të gjendjes civile.
→ Shih «Informacion i dobishëm»

Llojet e lejeve për të huajt:

Leja B: e qëndrimit

Leja C: e banimit

Leja G: për punonjësit ndërkufitarë

Leja L: për banuesit e përkohshëm

Leja F: për personat e pranuar përkohësisht

Leja N: për azilkërkuesit

Leja S: për personat që kanë nevojë për mbrojtje

3 Demokracia dhe federalizmi

Marrëveshjet ndërkombëtare

Anëtare e OKB-së dhe Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (SHETL), Zvicra përballet me politikën evropiane, si edhe me atë të huajën në përgjithësi, me kujdes dhe pragmatizëm. Pas dështimit të disa referendumeve mbi hyrjen e mundshme në BE, Zvicra ka zgjedhur një rrugë dypalëshe me Bashkimin Evropian, duke nënshkruar marrëveshje të shumta të cilat mes të tjerash lejojnë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mbështetjen e marrëveshjeve të asociimit me rregulloret Schengen dhe të Dublinit.

Zvicra është një shtet federal, i themeluar mbi tre nivele institucionale: Konfederata, 26 kantonet që e përbëjnë, dhe komunat. Kantonet janë autonome në kufijtë e njohur nga kushtetuta federale: secili prej tyre ka një kushtetutë të vetën, ligjet e veta, një qeveri të vetën, një parlament të vetin dhe gjykatat e veta. Komunat (rreth 3000 në Zvicër dhe 150 në Ticino) përfaqësojnë njësinë më të vogël institucionale dhe politike dhe gëzojnë një autonomi të përkufizuar nga kushtetutat e kantoneve të ndryshme. Veçantia e Konfederatës Zvicerane është se përbëhet nga katër kultura dhe gjuhë të ndryshme: ajo gjermanofone, frankofone, ajo italiane, e pranishme vetëm në Ticino dhe disa lugina të kantonit Grison, dhe ajo romanshë. Për t'u rezistuar tensioneve dhe ndryshimeve historike, që ka pësuar Evropa këto dy shekujt e fundit, Zvicra, kështu siç është ndërtuar pas vitit 1848, nuk mund të ishte tjetër veçse një konfederatë shtetesh të përbëra nga kantone dhe e rregulluar në mënyrë federaliste.

Federalizmi zviceran

Federalizmi nënkupton se, siç sanksionohet nga kushtetuta, kantonet dhe komunat gëzojnë autonomi të gjerë dhe koordinojnë funksionet e tyre. Së bashku me konfederatën ndahen edhe kompetencat politiko-administrative që ruajnë raporte të bashkëpunimit të ngushtë. Kantonet janë të lira të legjislojnë mbi të gjitha argumentet që nuk rregullohen nga kushtetuta federale.

Demokracia e drejtpërdrejtë

Zvicra ka një sistem të veçantë demokracie të drejtpërdrejtë, e cila shprehet përmes zgjedhjes popullore të drejtpërdrejtë të të gjitha posteve politike, përveç anëtarëve të qeverisë federale, si edhe përmes të drejtës së referendumit, të nismës dhe votimit popullor mbi çdo ndryshim të kushtetutës. E drejta e referendumit, ose ndryshe një konsultim popullor mbi një vendim të parlamentit, është e pranishme në kushtetutën zvicerane që prej vitit 1848. Falë nismës popullore, një numër i përcaktuar personash me të drejte vote mund të kërkojnë votim për ndryshimin ose shtimin e një neni të kushtetutës. Peticionet janë një e drejtë e njohur e shtetasve për t'iu drejtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë autoriteteve dhe mund të nënshkruhen edhe nga shtetasit e huaj. Zvicra ka një sistem shumëpartiak në të cilin asnjë parti nuk ka mundësinë të fitojë shumicën absolute: sensi i kompromisit është kështu një vlerë themelore për drejtimin e demokracisë zvicerane. Edhe sistemi zviceran i votimit është unik, nëse krahasohet me atë të demokracive të tjera moderne.



Ndarja e pushteteve mes Konfederatës, kantoneve dhe komunave

	Parlamenti	Qeveria	Magjistratura
Pushtetet / Funksionet	Legjislativ Formulimi i ligjeve Kontrollimi i qeverisë dhe administratës	Ekzekutiv Zbatimi i ligjeve, qeverisja, administrimi dhe përfaqësimi i shtetit në politikën e brendshme dhe të jashtme	Gjyqësor Gjykimi, dhënia e vendimeve, dënimi, mbrojtja
Zvicra	Asambleja federale Këshilli Kombëtar (200 anëtarë) Këshilli i Shteteve (46 anëtarë)	Këshilli federal (7 anëtarë të zgjedhur nga asambleja federale). Presidenti i Konfederatës votohet çdo vit nga parlamenti dhe zgjidhet mes këshilltarëve federalë	Gjykata federale (41 anëtarë të zgjedhur nga asambleja federale, numri është i ndryshueshëm)
Kantoni Ticino	Këshilli i Lartë (90 deputetë)	Këshilli i Shtetit (5 ministra)	Gjykatat civile: Gjykata e apelit Gjykata e paqes Gjykata e shkallës së parë Gjykatat penale: Gjykata e apelit Gjykata penale Gjykata penale e shkallës së parë Gjykata e të miturve Gjykatat administrative: Gjykata administrative Gjykata e sigurimeve Gjykata e shpronësimeve
Komunat	Këshilli komunal	Bashkia	

Anëtarët e Asamblesë Federale, të Këshillit të Shtetit, të Këshillit të Lartë, të bashkive dhe këshilleve komunale zgjidhen çdo 4 vjet nga personat me të drejtë vote.

Kushtet e të drejtës së votimit dhe të të drejtës për t'u zgjedhur në kantonin Ticino

Për shtetasit zviceranë është e nevojshme të kenë mbushur 18 vjeç dhe të jenë banorë të kantonit prej tridhjetë ditësh. Të huajt në Ticino nuk kanë të drejtë vote dhe të drejtën për t'u zgjedhur.

4 Jetesa në Ticino

Pjesa më e madhe e banorëve në Ticino përbëhet nga qiramarrës: të cilët banojnë në apartamente ose shtëpi me qira. Njoftimet për oferta qiraje (qiradhënie) gjenden sidomos në gazetat e përditshme ose në faqe interneti për këtë qëllim.
→ Shih «Informacion i dobishëm»

Pavarësisht nga kombësia dhe faktit nëse transferimi kryhet brenda një kantoni ose brenda Zvicrës, ose në një vend tjetër; përpara fillimit të procedurës së transferimit duhet të njoftohet pranë komunës ku ndodheni dhe komunës ku do të transferoheni (Shërbimi i kontrollit të banorëve), të lajmërohet zyra përkatëse rajonale për të huajt, zyra e sigurimeve shëndetësore dhe zyra postare në lidhje me ndryshimin e adresës, të njoftohet operatori i telefonisë fikse

Zviceranët i kushtojnë gjithmonë rëndësi të madhe riciklimit të mbetjeve. Në shumë kantone, secili paguan një taksë për grumbullimin në proporcion me sasinë e mbeturinave të depozituara në thasë. Përfitimi kryesor i këtij rregulli është ai i nxitjes sa më shumë të ndarjes së materialeve të riciklueshme, grumbullimi i të cilave është falas. Pjesa më e madhe e mbetjeve urbane riciklohet, nga e cila përfiton jo vetëm njeriu, por i gjithë mjedisi: mes tyre janë letrat, qelqi, shishet plastike (PET), kënaçet, kutitë, metalet, mbeturinat vegjetale. Çdo komunë ka qendra për grumbullimin e diferencuar. Nuk janë vetëm ekonomitë shtëpiake private të përfshira në riciklim: edhe bizneset kryejnë grumbullimin e diferencuar të mbeturinave.
→ Shih «Informacion i dobishëm»

(për anulimin dhe aktivizimin e lidhjes telefonike, internetit ose televizionit dixhital), të njoftohet Billag për abonimet radiotelevizive, t'i kërkohet punëdhënësit leje nga puna për të cilën keni të drejtë sipas ligjit, të njoftohet zyra e qarkullimit rrugor; të kontaktohet me mësuesit dhe autoritetet shkollore nëse keni fëmijë në moshë shkollore.

Përpara se të transferoheni në një apartament ose shtëpi, është e nevojshme të nënshkruhet një kontratë qiraje. Në pjesën më të madhe të rasteve duhet derdhur një paradhënie në një llogari rrjedhëse bankare të bllokuar. Personat që dëshirojnë të anulojnë një kontratë qiraje, duhet të respektojnë afatet e njoftimit të shënuara në kontratë. Qiradhënësi duhet të marrë njoftimin e anulimit një ditë përpara fillimit të afatit, i cili si rregull për apartamentet është tre muaj. Kontrata mund të ndërpritet përpara kohe nëse paraqitet një qiramarrës që mund të përbushë kushtet e kontratës. Në rast mosmarrëveshjeje me pronarin (qiradhënësin) gjatë qiramarrjes ose në përfundim të kontratës, mund t'i drejtoheni autoriteteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për dhënien e konsulencës për qiramarrësit dhe qiradhënësit, për të gjitha pyetjet në lidhje me marrëdhënien e qiramarrjes. Përveç shpenzimeve për qiranë, duhen paguar shpenzimet për energjinë elektrike, ujin, ngrohjen, televizorin kabllor, parkimin, heqjen e mbeturinave. Këto kosto pronari i apartamentit mund t'i ketë të përfshira në pagesën e qirasë me shënimin «Shpenzime shtesë». Të gjithë ata që disponojnë radio ose televizor, kompjuter, celular ose aparatura të tjera elektronike që lejojnë marrjen e valëve radiotelevizive janë të detyruar të paguajnë tarifën e Billag.

Raportet me fqinjët në përgjithësi disjplinohen nga rregullorja e brendshme e bashkëpronësisë ose me marrëveshje. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar shmangies së të folurit me zë të lartë, zhurmave dhe tingujve të bezdisshëm, në veçanti në mbrëmje, natën dhe gjatë ditëve të pushimit, respektimit të turneve në lavanderi, parkimeve të rezervuara dhe pastrimit të ambienteve të përbashkëta (shkallëve, ashensorit, garazheve, kopshtit, etj.), erërave të gatimit dhe tymit në rast gatimi në tarracë, heqjes korrekte të mbeturinave, respektimit të orareve të hapjes dhe mbylljes së portës kryesore të ndërtesës.

Nëse shqetësimet e krijuara nga fqinjët janë të shumta mund t'u drejtoheni autoriteteve për të zbatuar të drejtën tuaj. Shpesh, punimet e rikonstruktimit të shtëpisë ose punimet në një terren të afërt shkaktojnë shqetësime (zhurmat, shembjet). Edhe nëse janë të tepruara duhet të tolerohen dhe nuk mund të kërkohet që të eliminohen. Nëse punimet e ndërtimit provokojnë një dëm, mund të kërkohet dëmshpërblim në kushte të caktuara.

Shtetasit që vijnë nga shtetet anëtare të BE-së/SHETL-së me leje banimi dhe qëndrimi në Zvicër kanë të njëjtat të drejta me shtetasit zviceranë për sa i përket blerjes së pronave të paluajtshme ose apartamenteve në Zvicër për përdorim privat.





5 Gjuha italiane dhe bashkëjetesa

Historikisht, Zvicra është formuar në pikën e shkrirjes së tre kulturave dhe gjuhëve të mëdha evropiane, italishtes, frëngjishtes (le français) dhe gjermanishtes (die deutsche Sprache), të cilave u duhet shtuar edhe romanshë (rumantsch, romontsch ose rumauntsch), një nga gjuhët zyrtare të kantonit Grison, gjuhë neolatine që si e tillë ngjason shumë me gjuhën ladino dhe atë friulano që fliten në Itali dhe me disa dialekte lombe. Si rrjedhojë, Zvicra ka adoptuar katër gjuhë kombëtare, të cilat sot janë të sanksionuara nga kushtetuta federale (neni 4 dhe 70).

Zvicra është një vend shumëgjuhësor dhe multikultural: ka katër gjuhë kombëtare, por shpërndarja e tyre në territor nuk është homogjene. Gjermanishtja është kryesisht gjuha më e folur (64%): në 19 nga 26 kantone të Konfederatës. Gjuha më e përhapur është dialekti zviceran i gjermanishtes. Frëngjishtja (21%) flitet në rajonet perëndimore të vendit: 4 kantone janë plotësisht frankofone: Gjenera, Vaudi, Neuchâtel dhe Zhura. Në 3 kantone flitet frëngjisht dhe gjermanisht: Berna, Friburgo dhe Valeze. Italishtja (6,5%) flitet në Ticino dhe në katër lugina në kantonin Grison. Gjuha romanshë flitet në kantonin tregjuhësor të Grisonit së bashku me gjermanishten dhe italishten: si italishtja ashtu edhe frëngjishtja janë gjuhë me rrënjë latine. Flitet vetëm nga 0,5% e gjithë popullsisë zvicerane. Ndërsa gjuha serbo-kroate përfaqëson grupin më të madh gjuhësor të huaj. (Të dhënat e vitit 2012)

Në kantonin Ticino, ashtu si edhe në luginat grisoneze të Mesolçinës, Kalankas, Bregalias dhe Poskavos, gjuha zyrtare dhe e përditshme është italishtja. Shpesh në raportet mes miqve dhe familjarëve në Zvicrën italiane përdoret gjithashtu një dialekt lombard, me karakteristika të shumta vendase. Në Ticino kush frekuenton shkollën e detyruar mëson njëkohësisht të flasë dhe shkruajë edhe frëngjisht dhe gjermanisht, një rast ky i veçantë në nivel zviceran. Në kantonet gjermanofone (Zvicra gjermane) në jetën e përditshme është shumë e përhapur dhe e praktikuar gjermanishtja zvicerane (Schwyzerdütsch), një dialekt që nuk kuptohet menjëherë nga ata që kanë studiuar gjermanishten, dhe shpesh është mjaft e ndryshme nga rajoni në rajon. Në Romandi (Zvicra franceze) ka humbur përdorimi i dialekteve vendase, përveçse në Valeze, dhe në kantonet Friburgo dhe Zhura. Shumëgjuhësia dhe multikulturalizmi janë pjesë e procesit të vetëpërfshirjes kulturore zvicerane: **ndryshimi është kështu një nga vlerat zvicerane**. Megjithatë në dekadat e fundit, Zvicra ka evoluar nga një vend katërgjuhësh në një vend shumëgjuhësh: pluralizmi gjuhësor është shumëfishuar si rrjedhojë e përhapjes së gjuhës angleze dhe faktit se shumë shtetas të huaj vazhdojnë të praktikojnë gjuhën e tyre amtare. Gjuhët e folura në Zvicër sot janë mbi 40.

Për të njohur fqinjët tuaj, për të marrë pjesë në aktivitetet e komunitetit, për të kuptuar transmetimet radiotelevizive, për të lexuar gazetatat, për të kërkuar shtëpi ose punë, për të ditur se çfarë mësojnë fëmijët në shkollë dhe për të folur me mësuesit e tyre, për të komunikuar më mirë me administratën publike dhe shërbimet, për t'u ndierë në Ticino si në shtëpinë tuaj dhe për t'u informuar mbi Ticino në përgjithësi, duhet të kuptoni dhe flisni italisht. Administratat komunale (por jo vetëm ato) ofrojnë informacion mbi mundësitë e mësimi të italishtes dhe gjuhëve të tjera kombëtare. → Shih «Informacion i dobishëm»

Shtetasit zviceranë e dinë se sa e vështirë është ndonjëherë për të tjerët të kuptojnë gjuhët e tyre: por nëse një shtetas i huaj përpigjet të mësojë dhe kuptojë gjuhën e vendit ku banon, ky fakt i lehtëson shumë kontaktet, respektin, mirëkuptimin dhe njohjen reciproke. Përveç kurseve të gjuhës italiane, ka edhe kurse për socializimin, sensibilizimin, informimin mbi zakonet, traditat dhe parimet vendase. Në muajt e parë të banimit në Ticino, për të zhvilluar biseda të vështira mund të keni nevojë për një përkthyes të kualifikuar. → Shih «Informacion i dobishëm»

Regjistrimi në një shoqatë vendase është një rast i shkëlqyer për të krijuar kontakte të reja, sepse pjesa kryesore e jetës sociale të komunës dhe të kantonit zhvillohet në shoqata. Në shumë komuna ekzistojnë shoqata kulturore, sportive, për gratë, për prindërit ose për të rinjtë. Edhe në këtë rast, administrata komunale ofron informacione të dobishme.

Në Ticino ka shumë biblioteka, komunale ose kantonale, disa prej të cilave të specializuara në gjuhët amtare të të porsaardhurve, siç janë kurset e gjuhës së huaj dhe aktivitetet kulturore dhe argëtuese të organizuara nga shoqatat e ndryshme të komuniteteve të huaja. → Shih «Informacion i dobishëm»



6 Shkolla dhe formimi

Zvicra ka pak burime natyrore: për këtë arsye begatia e saj i detyrohet edhe kapacitetit intelektual të popullsisë dhe prandaj mbështetet së tepërmi në nivelet e shkëlqyera të arsimit publik.

Sistemi shkollor zviceran

Zvicra ka një sistem shkollor tepër të decentralizuar. Cikli i ulët fillor dhe cikli i lartë drejtohen nga kantonet, por numri i viteve të arsimit të detyrueshëm është i njëjtë në të gjithë vendin. Sistemi ndahet në katër nivele: parashkollori (çerdhja dhe kopshtet), shkolla e detyruar (cikli i ulët fillor dhe cikli i lartë), shkolla e mesme, formimi universitar dhe vazhdimi.

Për nxënësit, gjuha amtare e të cilëve nuk është italishtja, nevojitet mbështetje e veçantë: shkolla tiçineze ofron kurse të gjuhës italiane dhe aktivitete integruese. Studentët dhe të porsaardhurit e moshës mbi 16 vjeç mund të përfitojnë nga programi i propozuar nga Paratrajtimi i integritetit.
→ Shih «Informacion i dobishëm»

Stefano Franshini lindi në Bodio në vitin 1796. Ai u zgjodh këshilltar federal në vitin 1848. Nismëtari kryesor i krijimit të sistemit arsimor të kantonit Ticino, ai u mor me zhvillimin e shkollave të para publike të dala nga administrimi i urdhrave kishtarë. Mori pjesë edhe në themelimin e një instituti politeknik federal në Cyrih, kontribui në studimin e Historisë së Konfederatës Helvetike dhe hodhi themelet e Zyrës Federale të Statistikave. Gjithnjë nën stimulim e tij lindi Arkivi Federal Zviceran.

Arsimi i detyruar

Arsimi i detyruar zgjat 9 vjet dhe ndahet në ciklin e ulët fillor dhe ciklin e lartë. Edhe pse ekzistojnë shkolla të ndryshme private, pjesa më e madhe e nxënësve frekuenton shkollat publike. Moshë minimale për fillimin e ciklit të ulët fillor ndryshon nga kantoni në kanton: në Ticino është vendosur moshë 6 vjeç, ndërsa në të ardhmen shkollimi i detyrueshëm në të gjithë Zvicrën do të fillojë nga 4 vjeç. Në ciklin e lartë nxënësit marrin një edukim të përgjithshëm bazë. Disa shkolla ofrojnë arsimim praktik që i përgatit për praktikën, të tjera synojnë të zgjerojnë kulturën e përgjithshme për të lejuar hyrjen në nivel më të lartë. Roli i shkollës publike është i rëndësishëm edhe nga këndvështrimi i integritetit sepse mbledh 95% të nxënësve në vend me shumëllojshmërinë e kushteve sociale, gjuhësore dhe kulturore që sjellin. Duke qenë se është një vend me katër gjuhë kombëtare, Zvicra i jep një rëndësi të madhe studimit të gjuhëve. Gjatë viteve të shkollës së detyruar nxënësit studiojnë të paktën një gjuhë tjetër kombëtare: në Ticino frëngjishten dhe gjermanishten, përveç anglishtes.

Shkollat e mesme

Në moshën 16 vjeçare, nxënësit që kanë qëllim të vazhdojnë studimet fillojnë shkollat e mesme, të cilat zgjasin nga 3 ose 4 vjet: mund të zhvillojnë një praktikë për prijet për t'u përgatitur për të hyrë në botën e punës ose një formim që lejon më pas studimet universitare. Shkolla e mesme ofron një kulturë të përgjithshme dhe përgatit për provimet e maturës të cilat japin të drejtën e hyrjes në një nga 10 universitetet zvicerane, mes të cilave ai i Zvicrës italiane në Lugano dhe Mendrisio (Akademia e Arkitekturës), ose në një nga dy politeknikumet federale (Lozanë dhe Cyrih). Praktikantët në përfundim të periudhës së praktikës marrin një certifikatë federale aftësie, e njohur në të gjitha kantonet.



Formimi universitar i mëtjshëm

Shumë vazhdojnë formimin e tyre duke u regjistruar në një universitet ose në një nga shkollat universitare profesionale. Gjithashtu, ekzistojnë shumë kurse të përditësimit profesional dhe specializimit që ofrohen nga institucione private ose shoqata sindikale dhe profesionale. Universiteti dhe institucionet e tjera të larta ofrojnë edhe kurse të formimit të mëtjshëm.

Ticino ka një sistem universitar që përfshin fakultetet e ekonomisë, shkencave të komunikimit, arkitekturës, informatikës dhe teologjisë. Gjithashtu është e pranishme edhe SUPSI (Shkolla Universitare Profesionale e Zvicrës Italiane) që është në gjendje të ofrojë një mësim me orientim praktik. Qendra të rëndësishme kërkimore janë Instituti CIM (Computer Integrated Manufacturing) i Zvicrës italiane, Qendra Zvicerane e Kalkulimeve Shkencore, Instituti Dalla Molle për Inteligjencën Artificiale dhe Instituti i Kërkimeve në Biomedicinë.



Integrimi i të huajve dhe parandalimi i diskriminimit

Edhe në Ticino prania e të huajve (mbi 26% e popullsisë) është një fakt, pavarësisht nga përbërja, numri dhe nga perceptimi i saj. Integrimi pra është një nevojë që i imponohet si popullsisë zvicerane ashtu edhe asaj të huaj, dhe nënkupton vullnetin e mikpritjes nga vendasit dhe vullnetin për të hyrë në shoqërinë e re nga ana e të ardhurve. Bashkëjetesa, mirëkuptimi, toleranca dhe respekti reciprok mes kulturave të ndryshme konsiderohen të domosdoshme për zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik të shoqërisë, dhe bazohen mbi vlerat themelore të sanksionuara nga kushtetuta federale.

Me ligjin për të huajt, që hyri në fuqi në vitin 2008, dhe dekretin mbi integrimin e të huajve, për herë të parë objektivat e politikës zvicerane në lidhje me integrimin janë përfshirë në ligj. Në Ticino promovimi i integrimit të të huajve dhe parandalimit të diskriminimit është përcaktuar në nenin 2, shkronja d) e Ligjit të aplikimit në legjislacionin federal në lidhje me të huajt (1998). Nga ana e vet, kantoni ka krijuar figurën e të deleguarit kantonal për integrimin e të huajve dhe ka ngritur komisionin kantonal për integrimin e të huajve. Ekzistojnë komunitete dhe shoqata të shumta të huajsh që bashkëpunojnë me Zyrën e të Deleguarit kantonal për promovimin e përbashkët të integrimit të anëtarëve të vet përmes aktiviteteve dhe evenimenteve të ndryshme. Ligji penal kundër diskriminimit racia, neni 261 i shtuar; i Kodit Penal Zviceran, është një mjet i rëndësishëm për luftën kundër racizmit në Zvicër.
→ Shih «Informacion i dobishëm»

Komuniteti më i fortë i të huajve që banojnë në Ticino është ai italian, rreth 16% e popullsisë, e ndjekur nga ai i shtetasve ballkanikë (rreth 3%) dhe të Portugalisë (rreth 2,5%). Pjesa më e madhe e të huajve që banojnë në Ticino e ka prejardhjen nga kontinenti evropian: vetëm 2% vijnë nga Afrika, Azia dhe Amerika. Megjithatë, ndonjëherë për shkak të fakteve të kronikës ose lajmeve të raportuara nga media, perceptimi i shtetasve nuk korrespondon gjithmonë me realitetin e shifrave.

Në Ticino, në veçanti në rajonet Locarno dhe Liqenit Lugano, ka një prani të fortë të shtetasve gjermanofonë, në veçanti zviceranë dhe gjermanë, shpesh të moshuar pasanik që tërhiqen më shumë nga klima dhe peizazhi sesa nga kultura dhe gjuha vendase. Përveç kësaj, në kanton hyjnë çdo ditë për të punuar dhjetëra mijëra punonjës ndërkufitarë italianë. Gjithashtu, në Chiasso gjendet një nga katër qendrat e Zyrës Federale të Emigracionit për regjistrimin e azilkërkuesve.

Në Zvicër, ashtu si në gjithë Evropën, popullsia plaket dhe ka mungesë të krahut të punës. Pa punën e emigrantëve edhe në Ticino do të kërcënohej zhvillimi i sektorëve të tërë të ekonomisë. Shumë shërbime dhe biznese nuk do të funksiononin pa kontributin e tyre të domosdoshëm. Prania e të huajve në Ticino është një realitet shekullor: në vitin 1880 të huajt përfaqësonin 16% të popullsisë, 28% në vitin 1914, duke u ulur gjatë krizave ekonomike dhe Luftës së Dytë Botërore, për t'u rritur deri në vitin 1970. Bizneset tiçineze përballen prej dekadash me një nevojë për krah pune të cilin evolucioni normal i popullsisë lokale nuk është në gjendje ta plotësojë.





Struktura politike zvicerane karakterizohet nga federalizmi, autonomia e komunave dhe demokracia e drejtpërdrejtë. Prandaj, nuk ekziston gjithmonë një përgjigje e vetme për sfidat e integrit, me të cilat përballen institucionet në nivel kantonial si për shembull në shkollë ose në jetën profesionale. Autonomia tradicionale vendase bën që integrimi të kalojë para së gjithash përmes komuniteteve vendase.

Zvicra është një vend i vogël, me popullsi të dendur, me një infrastrukturë të zhvilluar dhe me standarde të larta jetese për pjesën më të madhe të popullsisë, ku falë emigracionit global kanë ardhur persona me zakone dhe konceptime të ndryshme për jetën. Gjuhët, kultura, zakonet, traditat dhe fetë e ndryshme takohen dhe përbëjnë një sfidë të madhe për bashkëjetesën reciproke. Nuk sjell zgjidhje një emigracion ku përqindja e punësimit mbetet e ulët për shkak të vështirësisë së integrit në tregun e punës. Për këtë arsye, integrimi duhet të lejojë edhe pjesëmarrjen e emigrantëve në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore. Për këtë duhet që të huajt të jenë të gatshëm të integrohen dhe që popullsia zvicerane të japë prova që është e hapur ndaj tyre. Integrimi kërkon pjesëmarrjen e të gjitha forcave të shoqërisë: Konfederata, kantonet, komunat, partnerët socialë, OJQ-të dhe organizatat e të huajve. Integrimi duhet të lejojë që të ndiheni dhe të jetoni në harmoni me shoqërinë pritëse: integrim do të thotë të përvetësosh kulturën e vendit pritës duke ruajtur rrënjët e tua, është të sjellësh dëshirën për të punuar, pjesëmarrjen dhe vlerat. Pra, integrim nënkupton të bësh pjesë në një bashkësi, në një plan barazie me vendasit.



8 Të punosh në Ticino

Ekonomia zvicerane bazohet në një prodhim cilësor dhe një krah pune tepër të kualifikuar. Fushat ekonomike më të rëndësishme përfshijnë bankat, sigurimet, turizmin, tregtinë, mikroteknologjinë, hi-tech, bioteknologjinë, farmaceutikën, ndërtimin. Sektori i shërbimeve ka numrin më të lartë të të punësuarve. Në Ticino sektorët kryesorë ekonomikë janë ai financiar, i trusteve, sigurimit, tregtar, bioteknologjik, ndërtimit dhe turizmit. Pjesa më e madhe e punonjësve banues në Zvicër punojnë në ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

Zviceranët punojnë shumë: mesatarja është prej 41,6 orësh në javë për punonjësit me kohë të plotë, të cilët kanë të drejtë për 20 ditë pushimi në vit. Këtyre u shtohen, sipas kantoneve, 8 ose 9 ditë festash publike. Grevat janë të rralla dhe nivelet e abstenimit janë minimale. Rrogat për nivele të njëjta pune mund të variojnë nga rajoni në rajon.

Ditët e festave në Ticino:

Viti i Ri (01.01)
Epifania (06.01)
Shën Jozefi (19.03)
E hëna e Pashkës
Dita e Punëtorëve (01.05)
Dita e Ngjitjes së Krishtit
E hëna e Rrëshajave
Corpus Domini
Shën Pjetri dhe Pali (29.06)
Festa Kombëtare e Zvicrës (01.08)
Dita e Shën Mërisë (15.08)
Dita e Gjithë Shenjtëve (01.11)
Ngjizja e Papërljer (08.12)
Krishtlindja (25.12)
Shën Stefani (26.12)

Në Zvicër nuk ekziston asnjë rrogë minimale e përcaktuar me ligj: si rregull kjo bëhet me marrëveshje mes punëdhënësit dhe vartësit. Në shumë sektorë, për shembull në atë të hotelieri-turizmit dhe në disa degë të industrisë së ndërtimit, ekzistojnë kontrata kolektive pune që parashikojnë kushtet e punës dhe rrogën minimale të detyrueshme. Për sektorë të tjerë profesionalë kanë hyrë në përdorim, në kuadër të masave shoqëruese të marrëveshjes mbi lëvizjen e lirë të njerëzve mes Zvicrës dhe Bashkimit Evropian, kontrata normale pune që parashikojnë rroga minimale të detyrueshme, si në sektorin e ekonomive shtëpiake, të call center ose qendrave estetike. Paga e caktuar në kontratë është një pagë bruto, nga e cila tërhiqen kontributet e sigurimeve shoqërore të detyruara siç janë AVS, AI, kontributet për pensionet, sigurimet kundër fatkeqësive dhe papunësisë. Puna në të zezë është e ndaluar dhe ndëshkohet. Shumë sindikata veprojnë në dobi të punonjësve në rastet e problemeve në punë, dhe jo vetëm.

→ Shih kapitullin 12 – Siguria shoqërore f.22
→ Shih «Informacion i dobishëm»

Për të punuar dhe jetuar në Zvicër është e nevojshme të pajiseni me leje të vlefshme qëndrimi dhe pune, pajisja me të cilat varion sipas kombësisë së kërkuesit. Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëdhënësit dhe punonjësve janë të përcaktuara nga Kodi i Përgjegjësisë, i ligjit federal mbi punën (mbrojtja për punonjësit) dhe dekretet përkatëse, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja maksimale e javës së punës dhe kohëzgjatja e pushimit. Si rregull, raportet e punës fillojnë me një periudhë prove gjatë të cilës aplikohen afate të shkurtra anulimi. Pas periudhës së provës, kontrata mund të anulohet duke respektuar afatet e anulimit. Punonjëset kanë të drejtë për leje lindje të paguar prej të paktën 14 javësh.

→ shih kapitullin 2 – Vendosija në Ticino f.6

Në rast pushimi nga puna këshillohet shumë të regjistroheni në Zyrën kompetente Rajonale të Punës (URC) që në momentin e paralajmërimit. Në Ticino vendet e lira të punës publikohen zakonisht në gazetat e përditshme ose në internet; marrëdhëniet personale luajnë gjithashtu rol të rëndësishëm në kërkimin e punës. Punonjësit me aktivitet jo të pavarur që nuk kanë mbushur 65 vjeç janë të siguruar në mënyrë të detyrues kundër papunësisë. Për të përfutur të drejtën e asistencës së papunësisë, të siguruarit duhet të kenë punuar për të paktën dymbëdhjetë muaj gjatë dy viteve të fundit, të jenë banues në Zvicër dhe të zotërojnë leje pune. Falë marrëveshjes për lëvizjen e lirë të njerëzve njihen edhe periudhat e kontributeve të kryera në një vend të BE-së/ SHETL-së.

→ shih kapitullin 2 – Vendosija në Ticino f.6

Shumë të rinj, në përfundim të shkollës së detyrues, frekuentojnë një kurs praktike (formim profesional bazë): ata marrin kështu një formim praktik dhe frekuentojnë një shkollë profesionale. Së bashku me formimin profesional mund të kryejnë edhe maturën profesionale. Institucione të ndryshme gjithashtu ofrojnë mundësinë e formimit profesional për të rriturit. Në Zvicër, punëdhënësit i japin një vlerë të madhe titujve të studimit dhe certifikatave të punës. Zyra Federale e Formimit Profesional dhe Teknologjisë merret me vlerësimin dhe ekuivalentimin e titujve dhe certifikatave të fituara jashtë vendit në të gjithë sektorin e formimit profesional dhe të shkollave të mesme të specializuara. Për diplomat, profesionet shëndetësore akademike dhe joakademike, ekzistojnë institucione të tjera kompetente.

→ Shih «Informacion i dobishëm»

Ekonomia, tatimet dhe mjetet e komunikimit

9

Praktikisht, pa burime minerale dhe me një sipërfaqe të kufizuar, Zvicra ia detyron begatinë e saj tregtisë me jashtë. Tregu i brendshëm relativisht modest ka bërë që produktet zvicerane të drejtohen përtej kufijve për të siguruar rendimentin e investimeve të kryera. Zvicra importon lëndë të para dhe eksporton mallra me cilësi shumë të lartë: e mbushur me ndërmarrje të vogla dhe të mesme, përgjithësisht me më pak se 250 të punësuar me kohë të plotë, të cilët përfaqësojnë rreth dy të tretat e totalit të forcës punonjëse. Sipërmarrja më e madhe zvicerane është Nestlé, grupi më i rëndësishëm ushqimor në botë.

→ shih kapitullin 7 – Të punosh në Ticino **f. 14**

Pothuajse të gjitha komunat e Ticino kanë një zyrë postare. Për letrat, korrespondenca ndahet në A (prioritare) dhe B. Pakot ndahen në Priority dhe Economy. Kostot variojnë sipas formatit, peshës dhe shpejtësisë së dërgesës që zgjidhet. Në zyrat postare mund të kryhen edhe pagesa ose operacione financiare falë shërbimeve të ofruara nga PostFinance. Sipas kërkesës, në rast të mungesës suaj të përkohshme, posta dhe pakot mund të qëndrojnë në pritje në zyrën postare e cila duhet të njoftohet menjëherë në rast transferimi.

Bankat, turizmi dhe tregtia

Pas maleve, çokolatës dhe djathit, imazhi që na vjen instinktivisht në mendje kur mendojmë për Zvicrën është padyshim ai që lidhet me bankat. Bankat janë aktorët kryesorë të qendrës financiare zvicerane, aktiviteti i privilegjuar i të cilave është administrimi i pasurive. Sektori financiar ka një rëndësi kyçe: kontribuon në krijimin e më shumë se 11% të të ardhurave të ekonomisë zvicerane. Mbi 6% e popullsisë është aktive në sektorin bankar; të sigurimeve dhe institucione të tjera financiare. Qendrat kryesore financiare janë Cyrihu, Gjeneva, Ticino dhe Bazeli. Në banka ose në postë mund të hapen llogari rrjedhëse ose llogari kursimi, ku mund të merren sipas kushteve të caktuara edhe kredi. Në më shumë se 60 000 bankomate mund të tërhiqen të holla dhe të kryhen operacione bankare. Kartat kryesore të kreditit pranohen kudo edhe në Ticino.

Një sektor tjetër jetësor për ekonominë zvicerane është turizmi, dhe në veçanti hoteleria dhe restorantet ku punojnë tradicionalisht shumë persona me origjinë të huaj. Ticino, dhe në veçanti rajonet Locarno/Ascona dhe Lugano, është një nga destinacionet kryesore turistike të vendit.

Në Ticino, dyqanet në përgjithësi janë të hapura nga ora 8:00 deri në 18:30, përveç të enjteve kur janë të hapura si rregull deri në 21:00. Të shtunave dyqanet nuk mbyllen përpara orës 17:00.

Disa qendra tregtare, dyqane të vogla lagjeje dhe karburante përfitojnë nga përjashtimet duke qëndruar hapur deri vonë në mbrëmje, të dielave ose gjatë ditëve të festave.

→ Shih «Informacion i dobishëm»

Taksat dhe deklarimi i të ardhurave

Kantonet dhe komunat caktojnë taksa për të ardhurat dhe pasurinë për personat që banojnë ose qëndrojnë në Ticino. Gjithashtu, ngarkohet edhe taksa federale e cila është direkt për Konfederatën. Punonjësit e huaj pa leje banimi u nënshtrohen një tatimi në burim mbi të ardhurat nga aktiviteti i punës. Tatimi në burim i zbritet drejtpërdrejt nga paga prej punëdhënësit. U nënshtrohen tatimeve edhe përfitimet që merren nga një ent sigurimesh që zëvendësojnë pagën siç janë përfitimet e sigurimit kundër papunësisë. Çdo vit është e nevojshme të plotësohet një deklaratë mbi të ardhurat. Komunat janë kompetente për dërgimin e deklaratave si edhe për hartimin taksave kantonale dhe komunale. Shumë ente publike e private dhe sindikatat mund të ndihmojnë në plotësimin e deklaratave. Informacione të mëtejshme mund të merrni pranë komunës ku banoni.

Mjetet e komunikimit

Mjetet e reja të komunikimit siç është interneti dhe telefonia celulare janë të përhapura kudo në Zvicër dhe kanë një përhapje të shkëlqyer. Rrjeti fiks dhe ai celular drejtohen nga disa operatorë në të gjithë vendin. Shumë shoqëri reklamojnë produkte të telefonisë. Madje është e mundur të përdoret internet për të telefonuar. Pjesa më e madhe e banesave marrin program radiofonik dhe televiziv kabllor. Shpesh për të marrë programet nga vendet jashtë Evropës, nevojitet pajisja me një antenë parabolike. Marrja radiotelevizive, edhe përmes celularit ose internetit, është me pagesë: duhet të regjistroheni në shoqatën Billag SA e ngarkuar për grumbullimin e tarifës, e cila kryen madje edhe kontrolle të rregullta.

→ Shih «Informacion i dobishëm»

Lëvizja 10



Në Zvicër mjetet lëvizin në të djathtë të rrugës dhe vlen rregulli i përparësisë nga e djathta. Në autostrada kufiri i shpejtësisë është 120 km/orë, në superstrada 100 km/orë, në rrugë kantonale 80 km/orë, në qendrat e banuara 50 km/orë dhe në disa zona rezidenciale 30 km/orë. Kufiri i alkoolit në gjak gjatë drejtimit të mjetit është 0,5 për mijë: për disa profesione, si p.sh. shoferët profesionistë, kufiri është vendosur në 0. Në rast kryqëzimi në rrugë të ngushta, automjeti që ngjitet ka përparësi ndaj automjetit që zbret. Rripi i sigurimit është i detyrueshëm në sediljet e përparme dhe të pasme dhe ndalohet zyrtarisht përdorimi i celularit gjatë drejtimit të mjetit.

Zvicra zotëron një nga rrjetet e transportit publik më të mirë në botë. Trenat, tramvajet, metrotë dhe autobusët qarkullojnë me një shpeshtësi të lartë dhe mbulojnë të gjithë territorin. Në Ticino, për shkak të formimit natyror të kantonit, për shkak të ofertës ndonjëherë të kufizuar dhe të disa zakoneve të konsoliduara, për transport synohet t'i jepet përparësi automjetit.



Mjetet publike të transportit

Qendrat urbane Lugano, Locarno, Mendrisio/ Chiasso dhe Bellinzona ofrojnë linja të shumta autobusësh urbanë dhe suburbanë me një shërbim të përditshëm të shkëlqyer; të shpeshtë dhe të rregullt, në përgjithësi nga ora 6:00 deri afërsisht në orën 23:45. Komunitatet periferike dhe luginat e Ticino lidhen me qendrat urbane falë shërbimeve të AutoPostale Svizzera SA dhe kompanive të tjera private të transportit. Shërbimi hekurudhor metropolitan TiLo ofron gjithashtu, çdo gjysmë ore, lidhje mes Airolo/Biasca dhe Chiasso/Como (S10), mes Chiasso dhe Milanos (S11), mes Castione-Arbedo/Bellinzona dhe Locarno (S20) dhe mes Castione-Arbedo/ Bellinzona dhe Luino/Aeroportit të Malpensës (S30). Linja S60 (FLP) lidh Lugano me Ponte Tresa dhe trenat rajonale FART Locarno me Domodossola.

Trenat e Hekurudhës Federale Zvicerane (FFS) përshkojnë Ticino dhe e lidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë me qytetet kryesore zvicerane dhe evropiane. Aeroporti Lugano (në Agno) bën që Ticino të bëjë pjesë në rrjetin ajror ndërkontinental falë lidhjeve me qendrat e Gjenevës, Cyrihut dhe Romës.

Në liqenet Maggiore dhe Lugano shërbejnë linja të shumta lundrimi. Shumë male të Ticino, si edhe disa fshatra të izoluar, arrihen me teleferikë me shina, teleferikë të thjeshtë, teleferikë me kabina, teleferikë me stola dhe me një hekurudhë me kremalierë.

→ Shih «Informacion i dobishëm»

Abonimi «Arcobaleno» lejon qarkullimin e lirë me të gjitha mjetet publike në zonën tarifore të Ticino. Me abonimin «Metà prezzo» është e mundur të përdoren të gjitha mjetet publike zvicerane me gjysmë çmimi. Në stacionet e trenit disponohen lloje të ndryshme zbritjeje dhe abonimesh për fëmijët, të rinjtë, studentët, familjet dhe të moshuarit. Shumë komuna ofrojnë lehtësira për abonime dhe karta ditore.

→ Shih «Informacion i dobishëm»



Leja e drejtimit

Për të drejtuar automjetin në Zvicër, nevojitet leja e drejtimit (për drejtuesin) dhe një leje qarkullimi (për mjetet motorike). Drejtuesit e mjeteve mund të përdorin patentën e huaj për kategoritë e mjeteve me vlefshmëri vetëm për 12 muajt e parë të qëndrimit në Zvicër (me leje qëndrimi B ose me leje banimi C). Për këtë nevojitet të keni mbushur moshën 18 vjeçare. Në përfundim të periudhës 12 mujore, shtetasi është i detyruar të kërkojë lejen zvicerane të drejtimit, patenta e huaj duhet të jetë regjistruar pranë Seksionit të Qarkullimit në Camorino dhe shtetasi i huaj do të marrë një patentë zvicerane. Për shtetasit e BE-së/SHETL-së, ndryshe nga ata që vijnë nga vende të treta, nuk ka provim për kontrollimin e drejtimit të mjetit. Personat që nuk zotërojnë leje drejtimi, duhet të ndjekin një autoshkollë dhe t'i nënshtrohen një provimi teorik, i cili mund të kryhet vetëm në njërin nga tre gjuhët kombëtare (italisht, frëngjisht dhe gjermanisht) dhe një provimi praktik.

→ Shih «Informacion i dobishëm»

Automjeti

Automjetet e importuara duhet të njoftohen menjëherë pranë doganës në momentin e hyrjes në Zvicër. Brenda periudhës prej një viti nga data e hyrjes në Zvicër (leje qëndrimi B ose me leje banimi C) shtetasi i huaj duhet të pajisë automjetin me targa dhe leje zvicerane të qarkullimit. Përpara dhënies së targave, automjeti duhet t'i nënshtrohet një kontrolli të kujdesshëm teknik. Të gjithë zotëruarit e një mjeti motorik janë të detyruar të nënshtrohen një policë për përgjegjësi civile (RC) që shlyen dëmet e shkaktuara nga kontraktori ndaj të tretëve. Përveç kësaj duhet të paguhet një taksë vjetore për qarkullimin rrugor: Sigurimi KASKO, jo i detyrueshëm, shlyen dëmet që i shkaktohen vetë automjetit.

Qarkullimi në autostradat zvicerane (në Ticino në autostradën A2 dhe A13) kërkon pagesën e një takse vjetore aforfe në formën e një pulle takse që është e detyrueshme të mbahet në xhamin e përparmë të automjetit. Parkimet kryesisht janë me pagesë. Zonat blu janë falas, por me kohë të kufizuar dhe kërkojnë vendosjen në xhamin e përparmë të një disku orar. Për të qarkulluar me biçikletë nuk nevojitet pulla e taksës: rekomandohet shumë kaska e mbrojtjes si edhe një sistem i përshtatshëm ndriçimi.

→ Shih «Informacion i dobishëm»



Shëndetësia

11

Enti Spitalor Kantonal tiçinez dallohet për shumëllojshmërinë e shërbimeve të ofruara shëndetësore cilësore të cilat u lejojnë pacientëve të gjejnë brenda një spitali specialistë të disiplinave të shumta. Prania e gjashtë strukturave në të gjithë territorin garanton gjithashtu një ofertë spitalore të plotë dhe të afërt, pavarësisht nga vendi ku kërkohen shërbimet. Në Ticino ka gjithashtu klinika private të specializuara të cilësisë së lartë, azile të shumta për të moshuar, institucione dhe struktura për persona me paafësi mendore dhe psikike, dhe shërbime kujdesi në shtëpi.

→ Shih «Informacion i dobishëm»

Promovimi i shëndetësisë synon të ruajë dhe shtojë potencialin shëndetësor të popullsisë. Tre sektorët tipikë të promovimit janë aktiviteti fizik, ushqyerja dhe koha e lirë. Higjiena dhe promovimi i shëndetit janë detyrat kryesore të shëndetit publik: Konfederata është e angazhuar mes të tjerash në luftën e parandalimit të sëmundjeve infektive dhe është përgjegjëse për sigurimet shoqërore, për kërkimet dhe mbrojtjen e mjedisit. Kantonet i sigurojnë popullsisë mbulim shëndetësor dhe mjekime, ndërsa komunat janë përgjegjëse për higjienën në nivel vendor. Kantonet dhe komunat merren gjithashtu me organizimin e shërbimeve të ndryshme mjekësore mes të cilave mjekët kantonalë, shërbimet e mjekëve dhe dentistëve të shkollave, si dhe shërbimet social-shëndetësore dhe social-psikiatrike.

Në Zvicër, çdo shtetas zgjedh mjekun e vet personal (mjekun e familjes). Këta përbëjnë pikën e parë të referimit ku duhet të drejtoheni për të gjitha problemet e shëndetit, edhe në raste emergjence. Në përgjithësi personi nuk i drejtohet drejtpërdrejt spitalit. Nëse nuk ka një gjuhë të përbashkët mes pacientit dhe mjekut, për të zhvilluar bashkëbisedime të specializuara këshillohet të merret me vete një përkthyes i kualifikuar.

→ Shih «Informacion i dobishëm»

Çdo person banues në Zvicër duhet të lidhë sigurim shëndetësor brenda tre muajve nga mbërritja e tij. Sigurimi shëndetësor i detyrueshëm u garanton të gjithëve akses në kura mjekësore të plota dhe të një cilësie të lartë brenda kantonit ku jeton. Kompania e sigurimit mund të zgjidhet lirisht mes rreth 90 zyrave të autorizuar të sigurimeve shëndetësore që ofrojnë shërbimet e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor. Zyra e sigurimeve shëndetësore duhet të sigurojë personin e interesuar pavarësisht nga mosha dhe gjendja shëndetësore, pa rezerva dhe pa afate pritjeje. Fëmijët duhet të jenë të siguruar brenda tre muajve nga lindja. Personat me banim të përkohshëm mund të përjashtohen nga detyrimi i sigurimit nëse disponojnë një mbulim sigurimi për mjekimet i cili ofron shërbime të paktën ekuivalente me zyrat zvicerane të sigurimeve shëndetësore.



Sigurimi shëndetësor (LAMal) mbulon kostot e sëmundjeve, të lindjeve dhe, nëse nuk parashikohet nga punëdhënësi, rastet e aksidenteve. Të punësuarit me të paktën tetë orë punë në javë janë të siguruar në mënyrë të detyrueshme ndaj aksidenteve jashtë punës (LAINF). Sigurimi i detyrueshëm mbulon kostot e kurave mjekësore ambulatorie që kryhen nga mjekët dhe medikamentet me recetë, shtrimin në repartet e përbashkëta të spitaleve të kantonit ku jeton, ose nëse është e nevojshme ose në rast urgjence, në spitalet jashtë kantonit. Përveç kësaj, përfshihen shërbimet e ndihmës dhe kurimeve në shtëpi (Spitex), kostot e qendrave mjekësore dhe kostot e rehabilitimit mjekësor. Trajtimet dentare hyjnë te sigurimet e detyruara vetëm nëse kanë lidhje me sëmundjet e rënda. Për këtë arsye, shpenzimet dentare duhet të paguhen nga vetë personi. Përveç mbulimit të detyrueshëm është e mundur të kryhen sigurime shtesë jo të detyrueshme që mbulojnë për shembull kostot e një komoditeti më të lartë për shtrimin në dhoma gjysmë-private ose private në spital dhe në klinika. Medikamentet që jepen vetëm me recetë jepen direkt nga mjeku ose mund të tërhiqen në farmaci. Medikamentet e tjera mund të gjenden edhe në dyqanin e herbalistit.

Primet e sigurimit shëndetësor variojnë sipas zyrës së sigurimit dhe vendit të banimit. Përfiton një skonto në primin e sigurimit ai që vendos të kufizojë zgjedhjen e mjekëve ose të spitaleve, ose të rrisë shumën e kufirit minimal të rimbursimit. Të siguruarit që vërtetojnë se janë në kushte modeste ekonomike kanë të drejtë për ulje të primit të sigurimit. Zyrat e sigurimeve shëndetësore rimbursojnë si rregull trajtimet e kryera ose të përshkruara nga mjekët, të cilët duhet të informojnë pacientët e tyre mbi shërbimet e parimbursuara.

→ Shih «Informacion i dobishëm»



Siguria shoqërore

12

Siguria shoqërore është një element vendimtar i shtetit zviceran. Pjesë e kësaj sigurie, **sistemi i tre shtyllave**, i themeluar në kushtetutë, garanton sigurinë shoqërore personale dhe profesionale si dhe atë të familjarëve, në rast pleqërie, invaliditeti ose vdekjeje. Sigurimet shoqërore financohen nga kontributi i të siguruarve, nga punëdhënësit, nga Konfederata dhe nga kantonet.

Nevojtarët ndihmohen nga asistenca publike (asistenca sociale). Pas një analize të kujdesshme dhe verifikimit të situatës së tyre personale, ata marrin minimumin e nevojshëm për jetesë dhe janë të siguruar në rast sëmundjeje. Të interesuarit marrin gjithashtu këshilla se si ta tejkalojnë sa më shpejt të jetë e mundur këtë fazë kritike dhe për t'i bërë më të përgjegjshëm për fatin e tyre dhe zgjedhjet që bëjnë. Përveç asistencës sociale të shtetit, ka një numër të madh institucionet publike që mbështesin personat që kanë nevojë për shërbime dhe ndihmë materiale. Kjo mbështetje nuk zëvendëson megjithatë asistencën sociale publike. Në shumë komuna ekziston madje mundësia për të marrë informacion shtesë pranë sporteveve Laps (Ligji për harmonizimin dhe koordinimin e shërbimeve sociale) dhe për të bërë kërkesë për shërbime sociale. Informacione të përgjithshme mund të merrni pranë komunave ku banoni.

Sistemi i tre shtyllave ndërtohet mbi bazat e mëposhtme: siguria shtetërore (shtylla e parë), ajo profesionale (shtylla e dytë) dhe ajo private (shtylla e tretë). Objektivi i këtyre tre shtyllave është të ruajë nivelin e jetesës së zakonshme edhe në rast pleqërie, invaliditeti dhe vdekjeje, për veten ose për të mbijetuarit.

Në **shtyllën e parë** gjejmë sigurimin për pleqërinë dhe të mbijetuarit (AVS) dhe sigurimi për invaliditetin (AI). Personat që banojnë ose punojnë në Zvicër bëhen automatikisht subjekt të sigurimit AVS dhe AI. Kontributet tërhiqen drejtpërdrejt nga paga, nga të ardhurat e biznesit ose nga pasuria personale. Burrat që kanë kaluar moshën 65 vjeçare dhe gratë që kanë kaluar moshën 64 vjeçare (gjendja në vitin 2012), mund të kërkojnë të marrin pagesat e AVS.

AVS është pika ku mbështetet ligji zviceran i sigurimeve shoqërore dhe parashikon derdhjen e dy pagesave kryesore: një për ata që kanë arritur moshën e pensionit, dhe tjetra për të mbijetuarit. Pagesa e pleqërisë garanton pavarësinë financiare për të siguruarit që janë tërhequr nga jeta profesionale. Pagesa për të mbijetuarit synon të mos lejojë që dhimbja e provokuar nga vdekja e një prindi ose bashkëshorti të shtohet nga një situatë financiare e pasigurt. Kjo pagesë u derdhet të mbijetuarve vejanë nëse kanë fëmijë ose nëse e veja ka kaluar moshën 45 vjeçare dhe ka qenë e martuar prej të paktën pesë vitesh. Një pagesë u takon edhe jetimëve deri në moshën 18 vjeçare ose nëse nuk kanë përfunduar akoma studimet, deri në moshën 25 vjeçare. Pagesa për invaliditetin derdhet për personat që, për shkak të sëmundjes, aksidentit ose sëmundjeve të lindura, paraqesin një shkallë invaliditeti prej të paktën 40%. Për të garantuar nevojat jetësore të përfutuesve të shtyllës së parë në AVS/AI përfshihen shërbime shtesë.



Siguria profesionale e detyrueshme (LPP) përfaqëson **shtyllën e dytë**. Së bashku me shtyllën e parë, siguria profesionale (sigurimet për pensionet) synon të garantojë ruajtjen e nivelit të jetesës së zakonshme gjatë pleqërisë, në rast invaliditeti ose vdekjeje. Të gjithë punonjësit me pagë që janë të siguruar në shtyllën e parë dhe fitojnë mbi 20 880 franga (gjendja në vitin 2012) në vit janë të siguruar në mënyrë të detyrueshme. Personat që ushtrojnë aktivitet fitimprurës të pavarur duhet të sigurohen sipas dëshirës. Ata që dëshirojnë, sipas rregullores së zyrës së tyre të pensioneve dhe kushteve të punëdhënësit të tyre, mund të kërkojnë një pension të parakohshëm.

Shtylla e tretë përbëhet nga siguria individuale (kursimet): shërbejnë për të garantuar standardin e jetesës së dëshiruar nga çdo shtetas. Siguria private ndahet në sigurinë e kursimeve (shtylla 3a) dhe sigurinë e lirë (shtylla 3b). Konfederata e mbështet shtyllën 3a me masa të politikës fiskale dhe promovimin e pronës së banimit. Bankat dhe kompanitë private të sigurimeve ofrojnë mundësi të mtejshme për sigurinë personale.

Grave, që gjatë 9 muajve përpara lindjes janë të mbuluara nga sigurimi AVS dhe kanë një periudhë prej të paktën pesë muaj eksperiencë pune, u takon asistenca e sigurimit të lindjes. Shërbimi ofrohet për 14 javët pas lindjes. Përfitimet familjare të zakonshme kontribuojnë në pagesën e një pjese të shpenzimeve financiare të të gjitha familjeve. Për adoleshentët dhe të rinjtë që studiojnë parashikohen përfitime për formimin. Kontributet financohen nga punëdhënësi i cili kujdeset për pagesën. Për familjet me fëmijë deri në 3 ose 15 vjeç, dhe me të ardhura të pamjaftueshme ekzistojnë përfitime të fëmijërisë së hershme dhe përfitime suplementare.

Ndërsa asistenca sociale garanton mbështetjen e personave që ndodhen në nevojë, inkurajon pavarësinë e tyre materiale dhe personale, ndjek integrimin e tyre social dhe profesional. Ajo jepet pavarësisht nga shkaqet që kanë shkaktuar të nevojshme këtë pagesë. Si rregull, asistenca sociale përfshin vlerësimin e detajuar të situatës së kërkuar: me të interesuarin hartohet një plan asistence të individualizuar dhe të përshtatur në funksion të situatës.



Familja 13

Familja sot përkufizohet si një komunitet jetese e themeluar mbi marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve. Ajo është një vend i privilegjuar strehimi që garanton dashuri, mbështetje dhe mbrojtje, një pikë referimi për të gjithë anëtarët e saj. Familja është një element themelor i shoqërisë, një realitet dashurie, edukues, kulturor, civil, ekonomik dhe social. Një vend takimi, mirëkuptimi, dialogu, respekti reciprok, i transmetimit të vlerave dhe solidaritetit mes brezave. Çdo individ fiton përvojat e para sociale në familje, e cila duhet të ofrojë një potencial për zhvillimin e burimeve të nevojshme për jetën, si për shembull mbështetjen, inkurajimin reciprok, ndarjen e përgjegjësisë, promovimin e autonomisë. Disa prej kulturave të origjinës së të huajve që janë vendosur në Ticino nuk kanë gjithmonë të njëjtin konceptim perëndimor për familjen, për barazinë gjinore dhe edukimin e fëmijëve: duke ruajtur njëkohësisht zakonet dhe traditat e origjinës në brendësi të bërthamës

Në rast vdekjeje, mjeku duhet të plotësojë certifikatën e vdekjes. Vdekjet në spital njoftohen drejtpërdrejt nga administrata e spitalit. Në raste të tjera u përket familjarëve të njoftojnë komunën, duke paraqitur certifikatën e vdekjes të lëshuar nga mjeku. Komunitat ofrojnë informacion mbi mundësitë e varrosjes dhe hapat që duhen kryer. Nëse dëshirohet një ceremoni fetare, ajo duhet të organizohet në mënyrë të pavarur. Për komunitetet e feve jo të krishtera, ekziston një varrezë myslimane dhe një varrezë hebraike, të dyja në Lugano.

familjare, shpresohet që të gjithë anëtarët e asaj familjeje të kenë rastin për t'u përballur me parimet dhe vlerat e vendit mikpritës jo vetëm përmes punës dhe shkollës, por edhe duke frekuentuar kurset e gjuhës italiane dhe të sensibilizimit në sistemin tonë, kurset për nënat me fëmijë në moshë parashkollore ose duke marrë pjesë në shoqata dhe evenimente.

Në Zvicër të gjithë burrat dhe të gjitha gratë kanë të drejtën të vendosin lirshëm personin me të cilin duan të martohen. Zyra e gjendjes civile kompetente për vendin e banimit të çiftit që do të martohet ofron informacion në lidhje me dokumentet e nevojshme dhe organizon martesën civile. Ata që dëshirojnë të celebrjnë edhe një ceremoni fetare duhet ta organizojnë atë me komunitetin e tyre fetar.

Martestat e përziera dhe të shtetasve të huaj

Kur një prej tyre ose të dy bashkëshortët e ardhshëm janë shtetas të huaj, në procedurën për celebrimin e martesës civile nevojitet paraqitja e një serie dokumentesh personale që merren nga vendi i origjinës ose përmes ambasadave apo konsullatave. Për këtë arsye është shumë e këshillueshme të disponohen me kohë të gjitha informacionet e nevojshme, përpara datës së zgjedhur. Kur bashkëshortët e ardhshëm kanë nënshtetësi të ndryshme mund të marrin pas martesës nënshtetësinë e bashkëshortit/bashkëshortes, nëse legjislacioni i vendeve përkatëse e parashikon këtë. Për martesat e përziera, është i detyruar banimi në Zvicër i shtetasit të huaj për kohëzgjatjen e bashkimit martesor për të paktën 5 vjet. Zyrat e gjendjes civile të zonës merren me procedurat përgatitore të martesës, celebrjnë martesën dhe lëshojnë certifikatat përkatëse. Në Zvicër partnerët e të njëjtës gini nuk mund të martohen, por kanë të drejtën të ndërtojnë një bashkim civil të regjistruar.

Bashkëjetesa, ndarja dhe divorci

Bashkëjetesa e personave që nuk janë të martuar ose në një bashkim civil të regjistruar nuk sjell pasoja. Me përjashtim të aksesit në disa shërbime sociale, në përgjithësi detyrat dhe përgjegjësitë për ta aplikohen si për çdo person tjetër beqar. Për bashkëjetesën, komuna e banimit dhe zyrat zonale të gjendjes civile, janë pikat kryesore të referimit. Pasojat e një ndarjeje ose e një divorci prekin aspektet personale dhe sociale, në veçanti nëse ka fëmijë, duke ndikuar ndonjëherë edhe në lejet e qëndrimit. Gjithnjë e më shumë, çiftet që ndahen ose divorcohen vendosin marrëveshje që disiplinojnë pasojat e vendimit të marrë. Kjo «zgjidhje» favorizohet nga fakti se rishikimi i Kodit Civil Zviceran ka anuluar përfundimisht konceptin e fajit, që i caktohej njërit prej bashkëshortëve.

Lindjet

Administrata e spitalit ia njofton menjëherë lindjet në spital zyrës së gjendjes civile kompetente. Lindjet që kryhen në shtëpi duhet t'i njoftohen personalisht zyrës së gjendjes civile nga ana e familjarëve, e mjekut ose e mjekut të obstetrikës. Të porsalindurit duhet të njoftohen brenda tre muajve nga lindja pranë një zyre të sigurimeve shëndetësore. Ata që dëshirojnë një ceremoni fetare duhet ta organizojnë atë me komunitetin e tyre fetar.



Fëmijëria dhe rinia

Si në të gjithë Evropën, edhe në Zvicër dhe në Ticino sot shumë persona preferojnë të blejnë objekte të përdorura dhe të dorës së dytë, që janë ende në gjendje të mirë dhe me çmim të ulët, si p.sh. lodra, libra, mobilie, takëme, elektro-shtëpiake dhe veshje. Në Ticino gjenden tregje të sendeve të përdorura në qytetet kryesore, falë edhe nismës së shoqatave si ACSI (www.acsi.ch), Caritas Ticino (www.caritas-ticino.ch), Kryqi i Kuq Zviceran Seksioni Ticino (www.redcross.ch) Emmaus (www.emmaus-arce.ch), dhe SOS Ticino (www.sos-ti.ch). Shumë komuna disponojnë gjithashtu qendra ekologjike ku mund të dërgohen mbeturinat shtëpiake dhe mbetjet vegjetale, të depozitohen mallra të përdorura dhe të gjenden objekte që janë ende të përdorshme.

Ticino favorizon autonominë dhe përgjegjësinë e familjeve duke dhënë mbështetje për aktivitete shtesë kontakti në familje dhe në shkollë gjatë orëve të punës ose të trajnimit të prindërve, për të favorizuar raportin e përshtatshëm mes familjes, punës dhe trajnimit. Struktura të shumta (çerdhet, familjet ditore, qendrat që organizojnë aktivitete jashtëshkollore, qendrat e socializimit) mbulojnë kënaqshëm nevojën në territorin kantonal dhe garanton cilësinë e kushteve të pritjes. Një aspekt tjetër mbështetës për familjet është ndihma për prindërit që kanë vështirësi në ushtrimin e rolit të tyre: për t'u përballur me këtë, Ticino mbështet entet, grupet dhe shoqatat që propozojnë projekte dhe shërbime në këtë drejtim.



Çerdhet dhe familjet ditore

Në çerdhet në Ticino si rregull dërgohen fëmijët e moshës nga 0 deri 3 vjeç. Konsiderohen çerdhe qendrat ditore me kapacitet pritës prej më shumë se 5 fëmijësh, të hapura më shumë se 15 orë në javë dhe që kanë marrë autorizim nga Këshilli i Shtetit. Çerdhet duhet të jenë të pajisura me pajisjet e nevojshme për pritjen e fëmijëve dhe për të zhvilluar aktivitetet e përditshme (gjumë, vakte dhe higjienë personale), si edhe me materiale të përshtatshme argëtuese dhe pedagogjike.

Familja ditore quhet personi, çifti apo familja që kundrejt një kompensimi modest, ofrohet të presë në kushtet e shtëpisë së vet, gjatë ditës (kryesisht drekës dhe pas shkollës) jo më shumë se 5 të mitur njëkohësisht, si rregull nën 12 vjeç. Në shumë komuna ka qendra që përfaqësojnë një rast të shkëlqyer socializimi për fëmijët dhe mbështetjeje për nënat. Ambulancat pediatrike, pediatrikët dhe shërbimet mjekësore në shtëpi ushtrojnë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve të fëmijës dhe nënës. → Shih «Informacion i dobishëm»

Gjatë viteve të para të jetës hidhen bazat e rëndësishme për zhvillimin e individit. Në Zvicër i kushtohet rëndësi e veçantë sektorit të mbështetjes së fëmijërisë së hershme, një mbështetje e rëndësishme për të gjithë fëmijët, që nxit zhvillimin e tyre motorik, gjuhësor, njohës dhe social. Mbështetja jepet nga një marrëdhënie e ngrohtë dhe siguroese me prindërit dhe nga një përjasje edukative koherente, si edhe një ndihmë e jashtme nga ana e personelit të specializuar. Fëmijët që rriten në familje në kushte jo të mira social-ekonomike rrezikojnë më shumë të kenë disavantazh në zhvillimin e tyre. Shpesh ky disavantazh shfaqet më vonë në formën e mundësive të minimizuara pas daljes nga shkolla, në formimin profesional dhe në tregun e punës. Fëmijët e emigrantëve përfitojnë më së shumti

nga ofertat për formim, ato ndihmëse dhe edukative në kuadër të mbështetjes që jepet gjatë fëmijërisë së hershme. Prandaj, objektivi është të rritet mundësia e aksesit në ofertat e destinuara për prindërit dhe fëmijët me prejardhje emigrante, të përmirësohen kompetencat ndërkulturore të personave të ngarkuar me asistencën. → Shih «Informacion i dobishëm»

Rinia dhe koha e lirë

Për të rinjtë, koha e lirë duhet të kuptohet si aktivitet jashtë procedurës shkollore ose të punës, si një moment formues dhe regjenerues për njeriun. Një vend i privilegjuar shoqërizimi dhe takimi ku adoleshentët të mund të eksperimentojnë, të gjejnë hapësirë për veprim dhe të zhvillojnë përvojat e nevojshme për të hyrë më pas në botën e të rriturve. Detyra e të rriturve duhet të jetë ajo që të stimulojnë, mbështesin dhe lejojnë të rinjtë të bëhen aktorë, protagonistë të kohës së tyre dhe të shmangin që të rinjtë të kthehen në spektatorë, konsumatorë pasivë të propozimeve të menduara, të realizuara dhe organizuara nga të tjerët. Ticino ofron për ta qendra të shumta aktivitete për të rinjtë, kampe, qendra argëtuese dhe aktivitete sportive. Përmes sportit, shumë të rinj të huaj dhe zviceranë mësojnë të takohen, të njihen, të përballen dhe të respektohen. Për të rinjtë ekziston gjithashtu mundësia të përfitojnë konsulencë dhe mbështetje ekonomike për projektet e tyre krijuese dhe shprehëse, si edhe të marrin pjesë në Këshillin Kantonal të të rinjve. → Shih «Informacion i dobishëm»

Feja 14

Prej shekujsh katolicizmi mbeti feja e vetme e lejuar në tokat që sot formojnë kantonin Ticino, aq sa në vitin 1555 pjesëtarë të komunitetit të reformuar të Locarno u dëbuan dhe gjetën strehim në Cyrih. Kështu, në kanton edhe dekadat pas pavarësisë (1803), feja katolike mbeti feja mbizotëruese. Sot, kushtetuta kantonale dhe kushtetuta federale sigurojnë liri të plotë për të adhuruar për besimtarët e të gjitha feve. Të drejtat themelore kushtetuese vlejnë për të gjithë personat dhe të gjitha komunitetet fetare: bëhet fjalë në veçanti për lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes dhe të lirisë për të adhuruar.

Deri në marrëveshjet e vitit 1884, mes Këshillit Federal dhe Selisë së Shenjtë nga ana kishtarë, Ticino varej pjesërisht nga Dioqeza e Milanos dhe pjesërisht nga ajo e Comos. Pas këtyre marrëveshjeve në vitin 1888 Papa Luani XIII, me anë të bulës Ad universam, krijoi Dioqezën e Lugano, duke themeluar Kishën Famullore dhe Kolegiale të San Lorenzo të Lugano në Katedrale. Në drejtimin e saj fillimisht nuk u vendos një peshkop, por një administrator apostolik. Në fakt vetëm në vitin 1971 Administrata Apostolike e Kantonit Ticino u shkëput ligjërisht nga Dioqeza e Bazelit dhe mund të flitej për herë të parë, zyrtarisht, për një Peshkop të Lugano. Deri më tani, si mbetje e ndarjes shekullore të Ticino dhe Dioqezës së Milanos dhe asaj të Komos, festohen si riti roman ashtu edhe riti ambrozian. Ndarja vërehet veçanërisht gjatë periudhës së karnavaleve.

Pra, në Zvicër nuk mund të favorizohet ose jo një person për shkak të zgjedhjeve dhe praktikave të tij fetare. Edhe për shkak të emigracionit të lartë, tabloja e besimeve është bërë tani e shumëllojshme dhe prania në Ticino e feve të tjera ose mënyrave të shprehjeve fetare është fakt: gjejmë pjesën më të madhe të përbërë nga katolikët (rreth 76%) e ndjekur nga protestantët, ortodoksët dhe myslimanët. Komuniteti hebraik është i përqendruar në Lugano.

Në Zvicër, si në Ticino, bashkëtojnë grupe të ndryshme fetare të cilat kanë mundësi të shumta të praktikojnë fenë e tyre në një klimë respekti, tolerance dhe privatësie. Me qëllim që të ketë liri besimi dhe ndërgjegjeje, shteti aplikon një neutralitet fetar. Ky neutralitet merr një rëndësi të veçantë në shkollat publike ku mësimi është i detyruar për të gjithë, pa dallim fetar. Pranimi në shkollat publike nuk mund të varet në asnjë rast nga feja. Mësuesit janë të detyruar të ruajnë një lloj maturie: në ushtrimin e funksioneve të tyre duhet të distancohen nga elementët fetarë që mund të shkaktojnë paragjykim të lirisë së besimit dhe ndërgjegjes të të tjerëve. Në Ticino fetë e njohura zyrtarisht janë ajo katolike dhe ungjillore e reformuar, që kanë statutin e shoqërive me të drejta publike. Komunitetet fetare që nuk njihen organizohen sipas të drejtës private dhe shpesh gëzojnë formën e shoqatave.

→ Shih «Informacion i dobishëm»

Kufizimet dhe detyrimet

Të drejtat themelore nuk kanë vlefshmëri absolute: ato mund t'u nënshtrohen kufizimeve nëse një ligj e parashikon këtë dhe nëse ka interes publik që justifikon kufizimin. Për shembull legjislacioni mund të kufizojë lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes nëse vihen në rrezik siguria dhe qetësia publike, ose shëndeti i popullatës dhe nëse ushtrimi i tyre prek të drejtat dhe liritë e të tjerëve.

Ndëshkohen manifestimet e intolerancës të atyre që lëndojnë ndjenjat fetare përmes një kritike sistematike dhe keqdashëse. Disa praktika fetare janë të ndaluara pasi dhunojnë të drejtat themelore. Praktikrat që vënë në rrezik integritetin fizik ose psikik të një personi, si p.sh. prerjet, dënohen pasi liria për të adhuruar nuk justifikon që t'i shkaktohet dëm një personi. Gjithashtu, disa praktika nuk lejohen në Zvicër kur shkelin për shembull ligjin për mbrojtjen e ujërave, i cili ndalon hedhjen e hirit të të vdekurve në ujërat e rrjedhshme, ose ligji për mbrojtjen e kafshëve që ndalon sjelljet mizore ndaj kafshëve. Bindjet fetare nuk sjellin përjashtim nga ushtrimi i përgjegjësisë civile të parashikuara nga ligji, konkretisht detyrimi për të ndjekur arsimin e detyruar. Si përfundim, kur një manifestim fetar zhvillohet në një vend publik, nevojitet të kërkohet autorizim nga komuna.



Koha e lirë dhe media

15

Shprehjet kulturore në Zvicër janë të influencuara deri diku nga diversiteti, që edhe vetë zviceranët ndonjëherë pyesin veten se çfarë i bashkon.

Kjo shumëllojshmëri reflektohet në një spektër të gjerë zakonesh, traditash dhe shprehjesh artistike që përfshijnë edhe kulturat e komuniteteve të shumta të të huajve që banojnë në vend.

Ofertat kulturore për kohën e lirë nuk mungojnë as në Ticino, ku ekziston edhe një numër i madh shoqatash kulturore dhe argëtuese në nivel komunal dhe rajonal. Për ata që vijnë në Ticino këshillohet vërtet të marrin pjesë në aktivitetet e shoqatave lokale ose në mundësitë argëtuese, sportive, ekskursioniste, gastronomike dhe kulturore: në fakt është një mënyrë e shkëlqyer për t'u njohur me banorët e kantonit, zakonet dhe traditat e tyre, mentalitetin e tyre dhe me disa tradita të cilat i kanë ruajtur. Disa flasin me dialekt, shijojnë së bashku një polenta dhe djathë, duke bërë një lojë me letra ose «bocce», përsëritin në kor refrenet e disa këngëve popullore. Këto veprime bëjnë jo vetëm që të porsaardhurit të tregojnë kuriozitet për kulturën e vendit pritës, por edhe nxitin interesin e vendasve, duke stimuluar hapjen me të tjerët dhe njohjen.

Një nga pasuritë më të rëndësishme të Ticino janë sigurisht prodhimet e saj eno-gastronomike. Prodhime origjinale që vijnë direkt nga territori dhe të realizuara falë traditave të lashta vendase. Një ofertë me mijëra shije që arrijnë të gërshetojnë tradicionalen dhe modernen, e cila varion nga specialitetet e stinës siç janë sallamet vendase, verërat Merlot, djathërat e kullotave alpine, deri te pjatat më klasike siç janë polenta, risotto me kërpudha dhe ossobuco, minestrone, krapi me lëng, keku ose keku me gështenja, pijet me gaz dhe specialitete të tjera që shijohen me kënaqësi të veçantë veçanërisht në kantinat tipike.

Traditat dhe kultura

Nga pranvera e deri në vjeshtë, jo vetëm në fshatra por edhe në luginë, ka një zinxhir festash, festimesh dhe «risottata» popullore shpesh të lidhura me figurat e shenjtoreve, me përvjetorët fetarë ose me traditat fshatare dhe gastronomike: rite dhe zakone që janë trashëgimi e civilizimit rural dhe fshatar që karakterizonte Ticino deri në mes të shekullit XX. Të shumta janë edhe evenimentet sportive që u lejojnë familjeve dhe miqve të mbledhen dhe të bëjnë së bashku xhiro me biçikleta, ndeshje futbolli, shëtitje dhe vrapime popullore. Edhe komunitetet e të huajve janë shumë aktive dhe ofrojnë rregullisht festa etnike që frekuentohen shumë dhe janë momente të privileguara takimi me tiçinezët.

Mes evenimenteve të mëdha kulturore të Ticino me famë ndërkombëtare, citojmë karnavalen Rabadan të Bellinzona, procesionet historike të Të premtes së Shenjtë në Mendrisio, Festivalin e Filmit të Locarno, festivalet e xhazit të Ascona dhe Lugano, koncertet «Moon and Stars» të Locarno dhe koncerte të shumta me muzikë klasike. Mes muzeve dhe galerive të artit numërohet edhe një javë që i dedikohet kulturës, e mbushur me art bashkëkohor, etnografi dhe shkencë. Ticino është edhe djep i trashëgimisë botërore për njerëzimin. Asaj i përkasin dy vende të listës së UNESCO-s: Mali San Giorgio, një thesar natyror ku janë zbuluar fosile dinozaurësh, dhe tre kështjellat mesjetare të Bellinzona.

Ticino ofron mundësinë e praktikimit të të gjitha sporteve, si të atyre në ambiente të hapura, edhe të atyre në ambiente të brendshme. Regjistrimi në një klub sportiv ose praktikimi i sportit në grup, janë një mënyrë e shkëlqyer për të lehtësuar njohjen reciproke mes vendasve dhe të huajve dhe për të stimuluar respektin e nevojshëm për njëri-tjetrin. Aktiviteti i punës vullnetare me të rinjtë, të moshuarit, të sëmurët ose personat me aftësi të kufizuara ofrojnë mundësi të çmuara shkëmbimi dhe mirëkuptimi.

Media

Në krahasim me numrin e banorëve, Ticino është një nga rajonet në botë me numrin më të madh të organeve të shtypit. Këtu gjejmë 3 gazeta lokale të përditshme, shumë të përjavshme, disa të përmuajshme (përveç të gjithë shtypit zviceran dhe gazetave kryesore të huaja që shiten në kioska), 6 kanale televizive kombëtare dhe 10 kanale radiofonike kombëtare (dhe një pafundësi rrjetesh të tjera zvicerane dhe të huaja falë transmetimit kabllor ose satelitor), 1 televizion privat, 2 radio private, dhe media të panumërta në internet. Leximi rregullisht i gazetave të përditshme, dëgjimi i lajmeve nga radiot e Zvicrës italiane dhe ndjekja e transmetimeve televizive që përfaqësojnë fakte dhe tradita vendase, ju mundëson që të jeni vazhdimisht të përditësuar me realitetin në të cilin jetoni, me opinionet e popullatës, me evoluimin e mentalitetit, dhe së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, të mësoni italishten. Shtypi vendas është gjithashtu mjeti i privilegjuar për të ndjekur dhe kuptuar ndryshimet social-ekonomike dhe politike të Ticino dhe Zvicrës.



16 Siguria dhe emergjencat

Policia kantonale është një shërbim publik që ka për detyrë të garantojë sigurinë dhe të ruajë rendin ligjor: **mund të kontaktohet 24 orë në ditë në numrin 117**. Policia kantonale parandalon dhe, kur është e mundur, ndalon shkeljet nëpërmjet informacionit dhe kontrollit, i vërteton ato dhe i denoncon pranë autoriteteve kompetente. Repartet e lëvizshme të xhandarmërisë të zonave Sopraceneri dhe Sottoceneri, sigurojnë në të gjithë territorin kantonal ndërhyrjet e jashtëzakonshme dhe të paplanifikuara, të urgjencës dhe ndihmës së shpejtë, ndalimin ose arrestimin e personave, si edhe shërbimin e patrullave me detyra të përgjithshme parandaluese dhe ndaluese.

Kush bëhet viktimë e një vjedhjeje me thyerje në shtëpi duhet të lajmërojë menjëherë policinë dhe duhet të mundohet të qëndrojë i qetë. Përpara se të hyjë në shtëpi duhet të presë ardhjen e agentëve të policisë: në fakt ka mundësi që vjedhësit të jenë ende brenda shtëpisë. Duhet të shmangët hyrja në banesë për të vënë në rregull ose prekur gjërat e shpërndara, sepse duke vepruar kështu mund të fshihen gjurmët që ka lënë vjedhësi. Mos hezitoni të kontaktoni policinë edhe për të sqaruar situata të mundshme jonormale.

Detyrat kryesore janë: parandalimi përmes pranisë në territor; kontrollimi i trafikut dhe personave, konstatimi i incidenteve të qarkullimit rrugor; incidentet ajrore dhe hekurudhore, konstatimi i vjedhjeve, grabitjeve dhe vandalizmave, aksidenteve në shtëpi dhe në punë, ndërhyrjet në zënka, agresione dhe dhunë në shtëpi, konstatimet e vdekjeve, zjarreve dhe shërbimi i ruajtjes së rendit. Policia gjyqësore kryen, në bashkëpunim me prokurorinë, mbledhjen e informacioneve, vërtetimin e fakteve, hetimet, arrestimet, parandalimin, analizat strategjike dhe krahasues të fenomeneve kriminale, aplikimin e metodave tekniko-shkencore.

Xhandarmëria territoriale u garanton konsulencë qytetarëve pranë sporteleve të policisë dhe në terren. Ushtron gjithashtu aktivitetin e policisë gjyqësore në lidhje me krimin ordiner duke hetuar mbi krimet e vogla. Është gjithashtu përgjegjëse për kontrollin dhe sigurinë e aeroportit të Lugano në Agno. Komunitat kryesore të Ticino kanë trupa komunale të policisë. Repartet e lëvizshme speciale kryejnë brenda territorit të brendshëm kantonal ndërhyrjet e specializuara dhe me rrezikshmëri të lartë. Ato përbëhen nga Reparti i Ndërhyrjes së Shpejtë dhe Reparti i Trafikut. Policia kantonale ndërhyrë çdo ditë për konstatimin e incidenteve të qarkullimit rrugor. Në rast incidenti shumë të rëndë ose kompleks, përfshihet edhe policia shkencore.

Në Ticino janë të pranishme agjenci të shumta të specializuara në sektorin e sigurisë të cilat mund të drejtoheni për konsulencë në këtë drejtim dhe për instalimin e pajisjeve të alarmit.

Në Ticino **shërbimet e ambulancës** dhe shoqatat që operojnë në fushën e ndihmës së shpejtë para-spitalore janë anëtare të Federatës Kantonale Tiçineze të Shërbimeve të Autoambulancave. Misioni parësor i Ndhmës së Shpejtë të Ticino 144 është të reagojë ndaj thirrjeve urgjente shëndetësore, të ofrojë një praktikë mjekësore të sigurt dhe një koordinim optimal të ndërhyrjeve. **Përmes numrit falas 144** është e mundur të zgjidhen të gjitha situatat e urgjencës ose emergjencës. Nuk është e nevojshme të telefonohet numri 144 për këshilla mjekësore (091 800 18 28), për informacione mbi shërbimet shëndetësore jashtë orarit (091 800 18 28), për kërkesa mbi Shërbimet e Ndhmës në Shtëpi (0840 22 44 22).

Shpëtimi dhe mbrojtja e personave, kafshëve, mjedisit dhe të mirave materiale: ky është misioni i përhershëm i **zjarrfikësve tiçinezë** të cilët përgjigjen në **numrin e urgjencës 118**.

Mbrojtja e popullsisë është një sistem i integruar për mbrojtjen, shpëtimin dhe dhënien e ndihmës. Misioni i saj konsiston në koordinimin e mjeteve të ndryshme të ndërhyrjes me qëllim mbrojtjen e popullsisë, bazat e saj të jetesës dhe të mirat kulturore në rast katastrofash natyrore dhe teknologjike, situatash të tjera të emergjencës dhe konfliktit të armatosur. Divizioni i ushtrisë dhe mbrojtjes së popullsisë ndahet në tre fusha aktiviteti dhe kompetence: sektori ushtarak, i mbrojtjes civile dhe i mbrojtjes së popullsisë. Sektori i mbrojtjes civile siguron aplikimin e dispozitave federale të mbrojtjes civile në rajone dhe në komuna, kujdeset për planifikime të ndryshme, trajnimin e ushtarakëve dhe realizimin e strukturave mbrojtëse (vendstrehime, impiantet rajonale). Shërbimi i mbrojtjes së popullsisë merret kryesisht me përgatitjen për rastet e emergjencës dhe katastrofave.

→ Shih «Informacion i dobishëm»



Bibliografia (përzgjedhje)

Abitare in Svizzera, Informazioni concernenti la locazione di un appartamento, Weissgrund Kommunikation, AG Zurigo, 2006, www.bwo-admin.ch

Assicurazioni sociali: soggiorno in Svizzera e partenza, Ufficio federale della migrazione, Berna, 2011, www.pubblicazionifederali.admin.ch

Benvenuti in Svizzera «Mirë, se vini në Zvicër» informazioni per gli immigrati, Ufficio federale della migrazione, Berna, 2011, www.pubblicazionifederali.admin.ch

Conoscere, conoscersi, Dicastero integrazione e informazione sociale Città di Lugano, Lugano, 2011, www.lugano.ch/diis

Curriculum di riferimento per la promozione delle competenze linguistiche dei migranti, Ufficio federale della migrazione, Berna, 2010, www.pubblicazionifederali.admin.ch

Echo, Informazioni sulla Svizzera, HEKS, Amriswil, 2005, www.echo-ch.ch

Dizionarietto elvetico, Eros Costantini, Edizioni San Giorgio, Muzzano, 2002

Géographie de la Suisse, AA.VV., LEP, Le Mont-sur-Lausanne, 2010, www.editionslep.ch

Guida alla salute in Svizzera, Croce Rossa Svizzera / UFSP, Berna, 2011, www.pubblicazionifederali.admin.ch

Histoire Suisse, Grégoire Nappey, LEP, Le Mont-sur-Lausanne, 2007, www.editionslep.ch

Il Ticino moderno 1945-2010, AA.VV., Quaderni dell'associazione Carlo Cattaneo, Lugano, 2010, www.associazionecattaneo.ch

Institutions politiques suisses, Vincent Golay, LEP,

Le Mont-sur-Lausanne, 2010, www.editionslep.ch
Istituzioni politiche svizzere, Vademecum, AA.VV., Giampiero Casagrande Editore, Lugano, 2004, www.casagrande-giampiero.ch

L'Image de la Suisse, Gianni Haver, LEP, Le Mont-sur-Lausanne, 2011, www.editionslep.ch

L'importanza di essere Svizzera, AA.VV., Limes, Rivista italiana di geopolitica, Gruppo Editoriale l'Espresso, Roma, 2011, www.limesonline.com

La Confederazione in breve, Cancelleria federale, Berna, www.pubblicazionifederali.admin.ch

La matrigna e il monello, Confederazione e Ticino tra dialoghi e silenzi, Orazio Martinetti, Armando Dadò Editore, Locarno, 2001, www.editore.ch

Le nostre origini, le terre ticinesi dai tempi remoti alla fine del Settecento, Raffaello Ceschi, Armando Dadò Editore, Locarno, 2006, www.editore.ch

Libera circolazione Svizzera-UE, Ufficio federale della migrazione, Berna, 2010, www.pubblicazionifederali.admin.ch

Lugano in mano, Vivi la tua Città, Dicastero integrazione e informazione sociale Città di Lugano, Lugano, 2011, www.lugano.ch/diis

La popolazione straniera e i flussi migratori in Ticino, AA.VV., SUPSI/Dipartimento lavoro sociale, Canobbio, 2003

La Svizzera in un libro, Lingue e cantoni, Elisabeth Alli, 2006, www.sbook.ch

Principi in materia di visti Schengen, Ufficio federale della migrazione, Berna, 2011, www.pubblicazionifederali.admin.ch

Razzismo e discriminazione, Dipartimento delle istituzioni, Bellinzona, 2012, di-ds@ti.ch

Razzista, io !?, Fondazione Educazione e Sviluppo, Lugano, 2005, www.globaleducation.ch

Staatsatlas / Atlas de l'Etat, AA.VV., Verlag Neue Zürcher Zeitung, Zürich, 2012, www.nzz-libro.ch

Stranieri e richiedenti l'asilo in svizzera, Ufficio federale della migrazione, Berna, 2012, www.pubblicazionifederali.admin.ch

Dialogo salute, Vademecum per la collaborazione con interpreti interculturali, Interpret, Berna, 2012, www.inter-pret.ch

Tutela giuridica della discriminazione razziale, Commissione federale contro il razzismo, Berna, 2010, www.ekradmin.ch

Vivere e lavorare in Svizzera, Ufficio federale della migrazione, Berna, 2010, www.swissemigration.ch – www.eures.ch

Shënim: Shumë publikime federale ekzistojnë në gjuhë të ndryshme përveç italishtes, frëngjishtes dhe gjermanishtes. Informacione të mëtejshme mund të merren pranë komunave ose pranë Zyrës së të Deleguarit kantonale për integrimin e të huajve, 0848 14 32 01/02.

Shënime

30 fjalë për të kuptuar italishten e folur në Ticino (përzgjedhje)

A balla	Me shpejtësi të lartë
(L')Agrafe	Kapëse metalike, huazim nga frëngjishtja
Azione	Ofertë speciale, shitje okazion me çmim të ulur; veçanërisht për ushqimet dhe mallrat e konsumit të vazhdueshëm. «Banane in azione» do të thotë thjesht «banane me çmim të ulur»; helvizim tipik komercial tregjuhësh (Action në frëngjisht, Aktion në gjermanisht)
Bilux	Pulsimi i fenerëve të përparmë të një automjeti, duke alternuar dritat e shkurtra me dritat e gjata, në përgjithësi për të tërhequr vëmendjen
Boccalino	Poç i vogël prej qeramike të ngjyrosur; që përdoret për të pirë verë vendase. Simboli i Ticino së bashku me zoccolette
(La)	
Cantonale	Rruga kryesore që lidh dy lokalitete
Classeur	Grumbullues, klasifikues (unazash)
Chifer	Cornetto, kruasant: panine e ëmbël ose briosh në formë gjysmëhëne
Colonna	Varg (maknash, njerëzish): përdorimi i kësaj fjale është i shpeshtë, veçanërisht për disa shprehje si «c'è colonna in autostrada»
Comanda	Porosi (në një restorant, në një dyqan, në internet). Bëhet fjalë për një huazim nga frëngjishtja
Entrare	
in funzione	Vendoset në detyrë, merr funksionet. Sipas frëngjishtes «entrer en fonction»
Farsi dentro	Të integrohesh, të mos qëndrosh i ndarë, të socializohesh = të krijosh raporte sociale me pjesëtarët e kolektivit ku hyn
Gabola	Hall, e papritur; e paparashikuar; vështirësi, fatkeqësi, gabim, incident, problem, rrëmujë, komplikim, bezdisje, kokëçarje
Inzigare	Ngacmoj, provokoj, shqetësoj
Latele	«Guardare latele», ose të shohësh një program televiziv

Macchina	
da lavare	Lavatriçe
Modine	Listela të ngulura në tokë për të treguar konturet e një ndërtese që po ndërtohet
Natel	Telefon celular: Termi është një shkurtime i NAtionales TELefon. Emri vjen nga viti 1975 kur PTT (sot Swisscom) vendosi të krijojë një rrjet të telefonisë celulare
Panne	Dëmtim, defekt, prishje, avari, keqfunksionim, gabim, incident, vështirësi, ndërprerje.
Per intanto	Për momentin
Riservazione	Prenotim, bëhet fjalë për një huazim nga frëngjishtja
Rolladen	Grilë që mblidhet ose tendë që mblidhet
Schlafsack	Thes lëkure. Termi gjermanisht «thes për të fjetur» ka mbetur në dialektin e italishtes tiçineze
Servisol	Vetëshërbim: restorant me vetëshërbim, dyqan me vetëshërbim
Tagliata	Pjatë me sallame të prera në feta, feta të përziera
Tirata	Rrugë e drejtë (për rrugët ose shtigjet që vazhdojnë në vijë të drejtë)
Tunnel	Galeri
Uovo	
in cereghino	Vezë e skuqur (sy)
Vignetta	Pullë me ngjitëse që vendoset në xhamin e përparmë dhe vërteton pagesën e taksës vjetore të nevojshme për të qarkulluar në autostrada
Zacky-boy	(Ose ndryshe zechiboy e të ngjashme) Prerëse shkurresh, pajisje e lëvizshme bujqësore me motor

Numra të dobishëm

Ambulanca	144
Policia	117
Zjarrfikësit	118
Emergjencia	112
Helmimet	145
Rega – ndihma e shpejtë ajrore	1414
Cardiocomo Ticino	091 80 53 1 11
Ndihma e shpejtë rrugore (avaritë)	140
Telefoni mik	143
Konsulencia për fëmijët dhe të rinjtë	147
AA Alkoolistët Anonimë	0848 84 88 46
Ndihma për AIDS në Ticino	091 923 80 40
Ngacmimet dhe konfliktet në punë	0800 14 51 45
Administrata kantonale	091 814 41 11
Zyra e emigracionit	091 814 72 11
I deleguari kantonal për integrimin	0848 14 32 01/02
Qendra e konsulencës për integrimin	0848 14 72 01/02
Shërbimi kombëtar i përkthimit	0842 44 24 42
Agjencia e ndërmjetësimit ndërkulturor	
Derman – SOSTicino	091 921 07 38
	091 825 23 79
Radiotelevizioni zviceran	091 803 51 11

Editore

Repubblica e Cantone Ticino
Dipartimento delle istituzioni
Residenza governativa
Piazza Governo
CH-6500 Bellinzona
tel. +41 91 814 41 11
www.ti.ch/di
di-dis@ti.ch

© Dipartimento delle istituzioni
CH-6500 Bellinzona
2012 Tutti i diritti riservati

Autore/Informazioni

Delegato cantonale
all'integrazione degli stranieri
Divisione degli interni
Dipartimento delle istituzioni
tel. +41 848 14 32 01/02

Concetto grafico

Graficadidee.ch – Giubiasco

Fotografie

Graficadidee.ch – Giubiasco
Archivio – EOC
Archivio – Croce Verde Bellinzona
Massimo Pacciorini – Job

Traduzioni

Consultra AG – Zurigo

Stampa

Salvioni arti grafiche
Stampato su carta FSC/100% riciclata

**Tiratura**

51'000 copie

1ª edizione/novembre 2012

Per quanto riguarda la correttezza dei contenuti dei testi fa stato unicamente la versione in italiano. I testi tradotti nelle altre lingue sono stati meticolosamente verificati nei limiti del possibile. Tuttavia, data la complessità della materia e delle diverse strutture governative, gli autori di questo documento non escludono il fatto che ci possano essere errori, imprecisioni o interpretazioni errate o offensive rispetto alla versione originale.

Benvenuti!



ti



Repubblica e Cantone Ticino
Dipartimento delle istituzioni